

**RREGULLORJA E ALOKIMIT TË KAPACITETIT DHE  
MENAXHIMIT TË KONGJESTIONIT**

\_\_\_\_\_ 2024

Kjo rregullore transponon Rregulloren e Komisionit (BE) 2015/1222, datë 24 korrik 2015, që përcakton një udhëzues për Alokimin e Kapacitetit dhe Menaxhimin e Kongestionit, siç është përfshirë dhe përshtatur me Vendimin e Këshillit Ministeror 2022/03/MC-EnC, datë 15 dhjetor 2022, mbi përfshirjen e Rregullores (BE) 2019/942, Rregullores (BE) 2019/943, Rregullores (BE) 2015/1222, Rregullores (BE) 2016/1719, Rregullores (BE) 2017/2195, Rregullores (BE) 2017/2196, Rregullores (BE) 2017/1485 mbi kuadrin ligjor të Komunitetit të Energjisë, duke amenduar Shtojcën I të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, dhe mbi ndryshimet e Vendimeve të Këshillit Ministeror 2021/13/MC-EnC dhe 2011/02/MC-EnC.

Në përputhje me variantin e CACM përshtatur me Vendimin e Këshillit Ministeror 2022/03/MC-EnC, datë 15 dhjetor 2022, nenet 17, 37, 64, 65, 66, 67 dhe 83, si dhe disa pika në akt janë pa përmbajtje dhe janë shënuar përkatësisht siç reflektuar në këtë Vendim të Këshillit Ministeror.

## Përmbajtja

Neni 1 Lënda dhe qëllimi .....	7
Neni 2 Përkufizimet .....	7
Neni 3 Objektivat e bashkëpunimit për alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongestionit. ...	11
Neni 4 Emërtimi dhe revokimi i emërtimit të NEMO-ve .....	11
Neni 5 Emërtimi i NEMO-ve në rast të një monopoli ligjor kombëtar për shërbime tregtare .....	14
Neni 6 Kriteret e emërtimit të NEMO.....	14
Neni 7 Detyrat e NEMO .....	15
Neni 8 Detyrat e OST-ve lidhur me bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë.....	17
Neni 9 Miratimi i termave dhe kushteve apo metodologjive .....	18
Neni 10 Menaxhimi i përditshëm i bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë.....	23
Neni 11 Përfshirja e palëve të interesuara .....	23
Neni 12 Konsultime .....	23
Neni 13 Detyrimet e konfidencialitetit.....	24
Neni 14 Afatet kohore të llogaritjes së kapacitetit .....	24
Neni 15 Rajonet e llogaritjes së kapacitetit.....	25
Neni 16 Metodologjia e dërgimit të të dhënave mbi gjenerimin dhe ngarkesën .....	26
Neni 17 Metodologjia e modelit të përbashkët të rrjetit.....	26
Neni 18 Skenarët .....	26
Neni 19 Modeli individual i rrjetit .....	27
Neni 20 Prezantimi i metodologjisë së llogaritjes të kapacitetit bazuar në flukse fizike .....	27
Neni 21 Metodologjia e llogaritjes së kapacitetit.....	29
Neni 22 Metodologjia e margjinës së besueshmërisë.....	30
Neni 23 Metodologjitë për kufijtë e sigurisë së operimit, kontigjencat dhe kufizimet e alokimit...	30
Neni 24 Metodologjia e faktorëve të zhvendosjes së gjenerimit.....	31
Neni 25 Metodologjia për veprime përmirësuese në llogaritjen e kapacitetit.....	31

Neni 26 Metodologjia e validimit të kapacitetit ndër-zonal.....	32
Neni 27 Dispozita të përgjithshme .....	32
Neni 28 Bashkimi në modelin e përbashkët të rrjetit .....	33
Neni 29 Llogaritja rajonale e kapacitetit ndër-zonal .....	33
Neni 30 Validimi dhe shpërndarja e kapacitetit ndër-zonal.....	35
Neni 31 Raporti dyvjeçar për llogaritjen dhe alokimin e kapacitetit.....	35
Neni 32 Rishikimi i konfigurimeve të zonave ekzistuese të ofertimit .....	36
Neni 33 Kriteret e rishikimit të konfigurimeve të zonave të ofertimit .....	38
Neni 34 Raportimi i rregullt për konfigurimin aktual të zonës së ofertimit .....	39
Neni 35 Ridispeçimi dhe tregtimi me kah të kundërt i koordinuar .....	40
Neni 36 Dispozita të përgjithshme .....	41
Neni 37 Zhvillimi i algoritmit .....	41
Neni 38 Objektivat e algoritmit të çmimit të tregut të bashkuar.....	41
Neni 39 Inputet dhe rezultatet e algoritmit të çmimit të tregut të bashkuar.....	42
Neni 40 Produktet e akomoduar .....	42
Neni 41 Çmimet maksimale dhe minimale.....	43
Neni 42 Çmimi i kapacitetit ndër-zonal të tregut të ditës në avancë .....	43
Neni 43 Metodologjia për llogaritjen e shkëmbimeve të skeduluara që rezultojnë nga bashkimi i tregut të vetëm të ditës në avancë .....	43
Neni 44 Përcaktimi i procedurave alternative.....	44
Neni 45 Marrëveshje lidhur me më shumë se një NEMO në një zonë ofertimi dhe për interkoneksionet që nuk operohen nga OST të çertifikuara .....	44
Neni 46 Sigurimi i të dhënave hyrëse.....	44
Neni 47 Funkionimi i bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë .....	45
Neni 48 Dorëzimi i rezultateve.....	45
Neni 49 Llogaritja e shkëmbimeve të skeduluara që rezultojnë nga bashkimi i tregut të vetëm të ditës në avancë.....	45
Neni 50 Fillimi i procedurave alternative .....	46
Neni 51 Objektivat e algoritmit të përputhjes së tregut të vazhdueshëm .....	46

Neni 52	Rezultatet e algoritmit të përputhjes së tregtimit të vazhdueshëm .....	46
Neni 53	Produktet e akomoduarra .....	47
Neni 54	Çmimet maksimale dhe minimale.....	47
Neni 55	Çmimi i kapacitetit brenda së njëjtës ditë .....	47
Neni 56	Metodologjia për llogaritjen e shkëmbimeve të skeduluara që rezultojnë nga bashkimi i tregut të vetëm brenda së njëjtës ditë.....	48
Neni 57	Marrëveshje lidhur me më shumë se një NEMO në një zonë ofertimi dhe për interkoneksionet që nuk operohen nga OST të certifikuarra .....	48
Neni 58	Sigurimi i të dhënave hyrëse.....	49
Neni 59	Funksionimi i bashkimit të tregut të vetëm brenda së njëjtës ditë .....	49
Neni 60	Dorëzimi i rezultateve .....	50
Neni 61	Llogaritja e shkëmbimeve të skeduluara që rezultojnë nga bashkimi i tregut të vetëm brenda së njëjtës ditë .....	50
Neni 62	Publikimi i informacionit mbi tregun .....	50
Neni 63	Ankandet rajonale plotësuese .....	51
Neni 64	Dispozita lidhur me alokimin eksplicit .....	51
Neni 65	Heqja e alokimit eksplicit .....	51
Neni 66	Dispozita lidhur me marrëveshjet e tregut brenda së njëjtës ditë .....	51
Neni 67	Kërkesa eksplicite për kapacitet.....	51
Neni 68	Klerimi dhe shlyerja.....	52
Neni 69	Afati i pandryshueshmërisë të ditës në avancë .....	53
Neni 70	Pandryshueshmëria e kapacitetit të ditës në avancë dhe kufizimet e alokimit .....	53
Neni 71	Pandryshueshmëria e kapacitetit brenda së njëjtës ditë.....	54
Neni 72	Pandryshueshmëria në rast të forcës madhore ose në situata emergjente.....	54
Neni 73	Metodologjia e shpërndarjes të të ardhurave nga kongjestioni.....	55
Neni 74	Metodologjia e ndarjes së kostos së ridispeçimit dhe tregtimit me kah të kundërt.....	55
Neni 75	Dispozita të përgjithshme mbi mbulimin e kostove .....	57
Neni 76	Kostot e themelimit, ndryshimit dhe funksionimit të bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë.....	57

Neni 77	Kostot e klerimit dhe shlyerjes.....	58
Neni 78	Kostot e themelimit dhe funksionimit të procesit të koordinuar të llogaritjes të kapacitetit .....	58
Neni 79	Kostot e sigurimit të pandryshueshmërisë .....	58
Neni 80	Ndarja e kostos ndërmjet NEMO-ve dhe OST-ve në Shtete Anëtare dhe Palë të ndryshme Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë.....	59
Neni 81	Delegimi i detyrave .....	59
Neni 82	Monitorimi i zbatimit të bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë.....	60
Neni 83	Dispozita kalimtare për Irlandën dhe Irlandën e Veriut .....	59
Neni 84	Hyrja në fuqi.....	61
Shtojca I	Rajonet e Llogaritjes së Kapacitetit .....	62
Neni 1	Objekti dhe fushëveprimi.....	62
Neni 2	Rajonet e Llogaritjes së Kapacitetit.....	62
Neni 3	Rajoni i Llogaritjes së Kapacitetit: SEE RLIK në Hije.....	62
Neni 4	Rajoni i Llogaritjes së Kapacitetit: ITME RLIK .....	63
Neni 5	Rajoni i Llogaritjes së Kapacitetit: EE RLIK.....	63

## **TITULLI 1**

### **Dispozita të përgjithshme**

#### **Neni 1**

#### **Lënda dhe qëllimi**

1. Kjo Rregullore përcakton udhëzime të detajuara për Alokimin e Kapacitetit dhe Menaxhimin e Kongjestionit ndër-zonal në tregjet e ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, duke përfshirë kërkesat për miratimin e metodologjive të përbashkëta për përcaktimin e volumeve të kapacitetit në disponim në të njëjtën kohë ndërmjet zonave të ofertimit, kriteret për të vlerësuar eficientësinë dhe një proces rishikimi për konfigurimin e zonave të ofertimit.

2. Në përputhje me Vendimin e Këshillit Ministeror 2022/03/MC-EnC, Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë kanë rënë dakord që dispozitat e Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 siç është përshtatur dhe miratuar nga ky vendim i Këshillit Ministeror, do të zbatohen tek të gjitha sistemet e transmetimit dhe interkoneksionet në Komunitetin e Energjisë, përveç sistemeve të transmetimit të cilat nuk janë të lidhura me sistemet e tjera të transmetimit nëpërmjet interkoneksioneve.

3. Në Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ku ka më shumë se një operator të sistemit të transmetimit, kjo Rregullore do të aplikohet tek të gjithë operatorët e sistemit të transmetimit që përfshihen brenda kësaj Pale Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë. Aty ku një operator i sistemit të transmetimit nuk kryen një funksion të rëndësishëm lidhur me një ose më shumë detyrime sipas kësaj Rregulloreje, Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë mund të vendosin që përgjegjësia për zbatimin e këtyre detyrimeve i caktohet një ose më shumë operatorëve të ndryshëm, specifikë të sistemit të transmetimit.

4. <...>

5. <...>

#### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

Për qëllimet e kësaj Rregulloreje do të aplikohen përkufizimet e Nenit 2, të Rregullores (BE) Nr. 2019/943, siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Këshillit Ministeror 2022/03/MC-EnC, Nenit 2, të Rregullores së Komisionit (BE) Nr. 543/2013, siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2015/01/PHLG-EnC, dhe Nenit 2, të Direktivës (BE) 2019/944 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Këshillit Ministeror 2021/13/MC-EnC.

Gjithashtu, do të aplikohen edhe këto përkufizime:

1. 'modeli individual i rrjetit' nënkupton një grup të të dhënave që përshkruan karakteristikat e sistemit elektroenergetik (prodhimi, ngarkesa dhe topologjia e rrjetit) dhe rregullat përkatëse për ndryshimin e këtyre karakteristikave gjatë llogaritjes së kapacitetit, përgatitur nga OST-të përgjegjëse, për t'u bashkuar me komponentë të tjerë të modelit individual të rrjetit për të krijuar modelin e përbashkët të rrjetit;

2. 'modeli i përbashkët i rrjetit' nënkupton një grup të gjerë të të dhënave të miratuara në përputhje me Nenin 2, Nr. 2, të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, dhe që shtrihet tek OST-të e Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë;
3. 'rajoni i llogaritjes së kapacitetit' nënkupton zonën gjeografike në të cilën aplikohet llogaritja e kapacitetit të koordinuar;
4. 'skenar' nënkupton gjendjen e parashikuar të sistemit elektroenergjetik për një periudhë kohore të përcaktuar;
5. 'gjendja neto' nënkupton shumën e netuar të eksporteve dhe importeve të energjisë elektrike për secilën njësi kohore të tregut për një zonë ofertimi;
6. 'kufizimet e alokimit' nënkupton kufizimet që duhet të respektohen gjatë alokimit të kapacitetit për të mbajtur sistemin e transmetimit brenda kufijve të sigurisë së operimit dhe që nuk janë përkthyer në kapacitet ndër-zonal ose që janë të nevojshme për të rritur efikasitetin e alokimit të kapacitetit;
7. 'kufijtë e sigurisë së operimit' nënkupton kufijtë e pranueshëm operativë për operimin e sigurtë të rrjetit, si kufijtë termikë, kufijtë e tensionit, kufijtë e rrymës së qarkut të shkurtër, kufijtë e frekuencës dhe stabilitetit dinamik;
8. 'metodologjia e kapacitetit të koordinuar neto të transmetimit' nënkupton metodën e llogaritjes së kapacitetit të bazuar në parimin e vlerësimit dhe përcaktimit ex-ante të shkëmbimit maksimal të energjisë ndërmjet zonave të ofertimit kufitare;
9. 'metodologjia e bazuar në flukse fizike' nënkupton metodën e llogaritjes së kapacitetit në të cilën shkëmbimet e energjisë ndërmjet zonave të ofertimit kufizohen nga faktorët e shpërndarjes së transferimit të energjisë dhe margjinat e disponueshme në elementët kritikë të rrjetit;
10. 'kontigjenca' nënkupton një defekt të identifikuar dhe të mundshëm ose tashmë të ndodhur të një elementi, duke përfshirë jo vetëm elementët e sistemit të transmetimit, por edhe përdorues të rëndësishëm të rrjetit dhe elementë të rrjetit të shpërndarjes, nëse janë të rëndësishëm për sigurinë e operimit të sistemit të transmetimit;
11. 'llogaritësi i kapacitetit të koordinuar' nënkupton subjektin ose subjektet që kanë për detyrë të llogarisin kapacitetin e transmetimit, në nivel rajonal ose më gjerë;
12. 'faktori i zhvendosjes së gjenerimit' nënkupton një metodë të konvertimit të ndryshimit të pozicionit neto të një zone të caktuar ofertimi në një injektim specifik të parashikuar në rritje ose në ulje në modelin e përbashkët të rrjetit;
13. 'veprim përmirësues' nënkupton çdo masë e zbatuar nga një ose disa OST, manualisht ose automatikisht, me qëllim ruajtjen e sigurisë së operimit;
14. 'margjina e besueshmërisë' nënkupton reduktimin e kapacitetit ndër-zonal për të mbuluar pasiguritë në llogaritjen e kapacitetit;
15. 'koha e tregut' nënkupton kohën verore të Evropës Qendrore ose kohën e Evropës Qendrore, cilado qoftë në fuqi;
16. 'të ardhurat nga kongjestioni' nënkupton të ardhurat e pranuar si rezultat i alokimit të kapacitetit;



17. 'kongjestioni i tregut' nënkupton një situatë në të cilën teprica ekonomike për bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë ose brenda së njëjtës ditë është kufizuar nga kapaciteti ndër-zonal ose kufizimet e alokimit;
18. 'kongjestioni fizik' nënkupton çdo situatë në rrjet ku flukset e parashikuara ose të realizuara të energjisë çenojnë kufijtë termikë të elementeve të rrjetit dhe stabilitetin e tensionit ose kufijtë këndorë të stabilitetit të sistemit elektroenergjetik;
19. 'kongjestioni strukturor' nënkupton një kongjestion në sistemin e transmetimit që mund të përcaktohet pa asnjë dyshim, është i parashikueshëm, është gjeografikisht i qëndrueshëm në kohë dhe ndodh shpesh në kushte normale të sistemit elektroenergjetik;
20. 'përputhje' nënkupton mënyrën e tregtimit përmes së cilës urdhërporositë e shitjes përputhen me urdhërporositë përkatëse të blerjes për të siguruar maksimizimin e tepricës ekonomike për bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë ose brenda së njëjtës ditë;
21. 'urdhërporosi' nënkupton qëllimin për të blerë ose shitur energji ose kapacitet, shprehur nga një pjesëmarrës i tregut që i nënshtrohet kushteve të përcaktuara të ekzekutimit;
22. 'urdhërporosi të përputhura' nënkupton të gjitha urdhërporositë e blerjes dhe shitjes që përputhen nga algoritmi i çmimeve ose algoritmi i përputhjes së tregtimit të vazhdueshëm;
23. Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) - nënkupton subjektin që është emërtuar nga autoriteti kompetent për të kryer detyrat e ndërlidhura me bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë ose brenda së njëjtës ditë;
24. 'libri i përbashkët i urdhërporosive' nënkupton një modul në sistemin e bashkimit të tregut të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë që mbledh të gjitha urdhërporositë e përputhura nga NEMO-t që marrin pjesë në bashkimin e tregut të vetëm brenda së njëjtës ditë dhe kryejnë përputhjen e vazhdueshme të këtyre urdhërporosive;
25. 'transaksion' nënkupton një ose më shumë urdhërporosi të përputhura;
26. 'bashkimi i tregut të vetëm të ditës në avancë' nënkupton procesin e ankandit të përcaktuar nga neni 2, nr. 26, i Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, dhe që shtrihet në zonat e ofertimit të Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë;
27. 'bashkimi i tregut të vetëm brenda së njëjtës ditë' nënkupton procesin e vazhdueshëm të përcaktuar nga neni 2, nr. 27, i Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, dhe që shtrihet në zonat e ofertimit të Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë;
28. 'algoritmi i çmimit të tregut të bashkuar' nënkupton algoritmin e përcaktuar nga neni 2, nr. 28, i Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, dhe që shtrihet në zonat e ofertimit të Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë;
29. 'algoritmi i përputhjes së tregtimit të vazhdueshëm' nënkupton algoritmin e përcaktuar nga neni 2, nr. 29, i Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, dhe që shtrihet në zonat e ofertimit të Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë;
30. 'funksioni i Operatorit të Bashkimit të Tregut (OBT)' nënkupton detyrën e përputhjes së urdhërporosive nga tregjet e ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë për zona të ndryshme të ofertimit dhe njëkohësisht alokimin e kapaciteteve ndër-zonale;

31. 'çmim klerues' nënkupton çmimin e përcaktuar duke përputhur urdhërporosinë më të lartë të pranuar për shitje dhe urdhërporosinë më të ulët të pranuar për blerje në tregun e energjisë elektrike;
32. 'shkëmbim i skedular' nënkupton një transferim të skedular të energjisë elektrike ndërmjet zonave gjeografike, për çdo njësi kohore të tregut dhe për një drejtim të caktuar;
33. 'llogaritësi i shkëmbimeve të skeduluara' nënkupton subjektin ose subjektet të ngarkuara me detyrën e llogaritjes së shkëmbimeve të skeduluara;
34. 'afati kohor i tregut të ditës në avancë' nënkupton afatin kohor të tregut të energjisë elektrike deri në kohën e mbylljes së portës të tregut të ditës në avancë, ku, për çdo njësi kohore të tregut, produktet tregtohen një ditë para livrimit;
35. 'afati i pandryshueshmërisë të tregut të ditës në avancë' nënkupton momentin në kohë pas të cilit kapaciteti ndër-zonal garantohet;
36. 'koha e mbylljes së portës të tregut të ditës në avancë' nënkupton momentin në kohë deri në të cilin pranohen urdhërporositë në tregun e ditës në avancë;
37. 'afati kohor i tregut brenda së njëjtës ditë' nënkupton afatin kohor të tregut të energjisë elektrike pas kohës së hapjes së portës të tregut ndër-zonal brenda së njëjtës ditë dhe para kohës së mbylljes të portës të tregut ndër-zonal brenda së njëjtës ditë, ku, për çdo njësi kohore të tregut, produktet tregtohen para livrimit të produkteve të tregtuara;
38. 'koha e hapjes së portës të tregut ndër-zonal brenda së njëjtës ditë' nënkupton momentin në kohë ku kapaciteti ndër-zonal ndërmjet zonave të ofertimit vihet në dispozicion për një njësi të caktuar kohore të tregut dhe për një kufi të caktuar të një zone ofertimi;
39. 'koha e mbylljes së portës të tregut ndër-zonal brenda së njëjtës ditë' nënkupton momentin në kohë ku pas të cilit alokimi i kapacitetit ndër-zonal nuk lejohet për një njësi kohore të tregut;
40. 'moduli i menaxhimit të kapacitetit' është një sistem që përmban informacion të përditësuar mbi kapacitetin e disponueshëm ndër-zonal për qëllimin e alokimit të kapacitetit ndër-zonal brenda së njëjtës ditë;
41. 'produkt jo standard brenda së njëjtës ditë' nënkupton një produkt për bashkimin e vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë jo për livrim të vazhdueshëm të energjisë ose për një periudhë që tejkalon një njësi kohore të tregut me karakteristika specifike të përcaktuara për të pasqyruar praktikat e funksionimit të sistemit ose nevojat e tregut, për shembull, urdhërporosi që mbulojnë disa njësi kohore të tregut ose produkte që pasqyrojnë kostot e vënies në punë të njësisë së prodhimit;
42. 'kundërpala qendrore' nënkupton subjektin ose subjektet që janë ngarkuar me detyrën e lidhjes së kontratave me pjesëmarrësit e tregut, nëpërmjet kalimit të kontratave që rrjedhin nga procesi i përputhjes dhe organizimit të transferimit të pozicioneve neto që rrjedhin nga alokimi i kapacitetit me kundërpalë të tjera qendrore ose agjentë të transferimit;
43. 'agjent transferimi' nënkupton subjektin ose subjektet që janë ngarkuar me detyrën e transferimit të pozicioneve neto ndërmjet kundërpalëve të ndryshme qendrore;
44. 'pandryshueshmëria' nënkupton një garanci që të drejtat e kapacitetit ndër-zonal do të mbeten të pandryshuara dhe se një kompensim do të paguhet nëse ato ndryshohen;

45. 'forcë madhore' nënkupton çdo ngjarje ose situatë të paparashikueshme ose të pazakontë përtej kontrollit të arsyeshëm të një OST-je, dhe jo për shkak të fajit të OST, e cila nuk mund të shmanget ose tejkalohet me largpamësi dhe kujdes të arsyeshëm, e cila nuk mund të zgjidhet me masa të cilat nga pikëpamja teknike, financiare ose ekonomike janë në mënyrë të arsyeshme të mundshme për OST, gjë që ka ndodhur realisht dhe është objektivisht e verifikueshme, dhe që e bën të pamundur për OST përmbushjen, e përkohshme ose të përhershme, të detyrimeve të saj në përputhje me këtë Rregullore;

46 'teprica ekonomike për bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë ose brenda së njëjtës ditë' nënkupton shumën e: (i) tepricës së furnizuesit për periudhën relevante kohore në tregun e bashkuar të vetëm të ditës në avancë ose brenda së njëjtës ditë, (ii) tepricës së konsumatorit për tregun e bashkuar të vetëm të ditës në avancë ose brenda së njëjtës ditë, (iii) të ardhurave nga kongjestionit dhe (iv) kostove dhe përfitimeve të tjera të ndërlidhura kur këto rrisin eficiencën ekonomike për periudhën përkatëse kohore, ku teprica e furnizuesit dhe e konsumatorit është diferenca ndërmjet urdhërporosive të pranuar dhe çmimit/njësi klerues të energjisë, shumëzuar me vëllimin e urdhërporosive të energjisë elektrike;

47. 'Shtet Anëtar' nënkupton një territor të Bashkimit Evropian të përmendur në Nenin 27 të Traktatit.

### **Neni 3**

#### **Objektivat e bashkëpunimit për alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestionit**

Kjo rregullore synon:

- (a) promovimin e konkurrencës efektive në prodhimin, tregtimin dhe furnizimin me energji elektrike;
- (b) sigurimin e përdorimit optimal të infrastrukturës së transmetimit;
- (c) garantimin e sigurisë së operimit;
- (d) optimizimin e llogaritjes dhe alokimit të kapacitetit ndër-zonal;
- (e) sigurimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminues të OST-ve, NEMO-ve, Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë, autoriteteve rregullatore dhe pjesëmarrësve të tregut;
- (f) sigurimin dhe rritjen e transparencës dhe besueshmërisë së informacionit;
- (g) mbështetje për operimin dhe zhvillimin eficient afatgjatë të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike dhe sektorit të energjisë elektrike në Komunitetin e Energjisë;
- (h) respektimin e kërkesës për një treg të drejtë dhe të rregullt dhe për formim të drejtë dhe të rregullt të çmimeve;
- (i) ofrimin e rregullave të njëjta për të gjithë NEMO-t;
- (j) ofrimin e kushteve mosdiskriminuese për akses në kapacitetin ndër-zonal.

### **Neni 4**

#### **Emërtimi dhe revokimi i emërimit të NEMO-ve**

1. Çdo Palë Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë e lidhur me sistemin energjetik në një zonë ofertimi të një Pale tjetër Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shteti Anëtar do të sigurojë

emërtimin e një ose më shumë NEMO-ve brenda gjashtë muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje për të kryer procesin e bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe/ose brenda së njëjtës ditë. Për këtë qëllim, operatorët e tregut, vendas dhe të huaj, mund të ftohen të aplikojnë për t'u emërtuar si NEMO.

2. Çdo Palë përkatëse Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë do të sigurojë emërtimin e të paktën një NEMO në çdo zonë ofertimi në territorin e saj. NEMO-t do të emërtohen për një mandat fillestar prej katër vitesh. Përveç kur zbatohet Neni 5(1), Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë duhet të lejojnë aplikime për emërtim të paktën një herë në vit.

3. Vetëm në rast se parashikohet ndryshe nga Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, autoritetet rregullatore do të jenë autoriteti i emërtimit, përgjegjës për emërtimin e NEMO-ve, monitorimin e përputhshmërisë me kriteret e emërtimit dhe, në rastin e monopolit ligjor kombëtar, miratimin e tarifave të NEMO ose metodologjisë për llogaritjen e tarifave të NEMO. Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë mund të parashikojnë që autoritete të tjera përveç autoriteteve rregullatore të jenë autoriteti i emërtimit. Në këto rrethana, Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë do të sigurojnë që autoriteti emërtues të ketë të drejta dhe detyrime të njëjta me autoritetet rregullatore, në mënyrë që të kryejë efektivisht detyrat e tij.

4. Autoriteti i emërtimit do të vlerësojë nëse kandidatët për NEMO përmbushin kriteret e përcaktuara në Nenin 6. Këto kriteret do të zbatohen pavarësisht nëse caktohet një ose më shumë NEMO. Kur vendoset për emërtimin e NEMO-ve, duhet të shmangët çdo diskriminim ndërmjet aplikuesve, veçanërisht ndërmjet aplikuesve vendas dhe të huaj. Nëse autoriteti i emërtimit nuk është autoriteti rregullator, autoriteti rregullator do të japë një opinion mbi masën në të cilën aplikuesi për emërtim i plotëson kriteret e përcaktuara në Nenin 6. Emërtimi i NEMO do të refuzohet vetëm kur nuk plotësohen kriteret e emërtimit në Nenin 6 ose në përputhje me Nenin 5(1).

5. Një NEMO i emërtuar në një Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shtet Anëtar ka të drejtë të ofrojë shërbimet e tregut të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë me livrim tek një Palë Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë ose Shtet Anëtar. Rregullat e tregtisë në Palën Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shtetin Anëtar përkatës do të aplikohen pa qënë nevoja të emërtohet si NEMO në atë Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shtet Anëtar. Autoritetet e emërtimit do të monitorojnë të gjithë NEMO-t që ofrojnë shërbimet e tregut të ditës në avancë dhe/ose brenda së njëjtës ditë brenda zonës së Palës së tyre Kontraktuese ose Shtetit Anëtar. Në përputhje me Nenin 19 të Rregullores (BE) Nr. 714/2009, autoritetet e emërtimit do të sigurojnë përputhshmërinë me këtë Rregullore të të gjithë NEMO-ve që ofrojnë shërbimet e tregut të ditës në avancë dhe/ose brenda së njëjtës ditë brenda zonës së një Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, pavarësisht se ku është emërtuar si NEMO. Autoritetet e ngarkuara me emërtimin, monitorimin dhe zbatimin e NEMO-ve, do të shkëmbejnë të gjithë informacionin e nevojshëm për një mbikëqyrje eficiente të aktiviteteve të NEMO-ve.

Një NEMO i emërtuar duhet të njoftojë autoritetin e emërtimit të një Palë tjetër Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shteti Anëtar, nëse propozon të ofrojë shërbimet e tregut të ditës në avancë ose brenda së njëjtës ditë brenda zonës së asaj Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shteti Anëtar, dy muaj përpara fillimit të ofrimit të shërbimit.

6. Me përjashtim të paragrafit 5 të këtij neni, një Palë Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë ose Shteti Anëtar mund të refuzojë ofrimin e shërbimeve tregtare nga një NEMO i emërtuar në një Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shtet Anëtar nëse:

(a) ekziston një monopol ligjor kombëtar për shërbimet e tregut të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë në Palën Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shtetin Anëtar ose në zonën e ofertimit të Palës Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shtetit Anëtar ku livrimi kryhet në përputhje me Nenin 5(1); ose

(b) Pala Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë ose Shteti Anëtar ku kryhet livrimi mund të përcaktojë se ka pengesa teknike për livrimin në atë Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shtet Anëtar të energjisë elektrike të blerë në tregjet e ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë me anë të NEMO të emërtuar në një Palë tjetër Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shtet Anëtar, lidhur me nevojën për t'u siguruar që objektivat e kësaj Rregulloreje janë përmbushur duke ruajtur sigurinë e operimit; ose

(c) rregullat e tregut në Palën Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shtetin Anëtar të livrimit nuk janë në përputhje me livrimin, në atë Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shtet Anëtar, të energjisë elektrike të blerë në bazë të shërbimeve të tregut të ditës në avancë ose brenda së njëjtës ditë ofruar nga një NEMO emërtuar në një tjetër Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shtet Anëtar; ose

(d) NEMO, në përputhje me Nenin 5, është një monopol ligjor kombëtar në Palën Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shtetin Anëtar ku është emërtuar.

7. Në rast të një vendimi për të refuzuar shërbimet e tregut të ditës në avancë dhe/ose brenda së njëjtës ditë me livrim në një Palë tjetër Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shtet Anëtar, Pala livruese Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë do t'i njoftojë vendimin e saj NEMO dhe autoritetit të emërtimit të Palës Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shtetit Anëtar ku është emërtuar si NEMO, si dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se Shtetet Anëtare preken, Komisionit Evropian dhe Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë. Refuzimi duhet të arsyetohet siç duhet. Në rastet e përcaktuara në nënparagrafët 6(b) dhe 6(c), vendimi për të refuzuar shërbimet e tregtimit me livrim në një Palë tjetër Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shtet Anëtar do të përcaktojë gjithashtu se si dhe deri kur mund të kapërcehen pengesat teknike për tregtimin ose rregullat e brendshme të tregtisë mund të bëhen të pajtueshme me shërbimet tregtare me livrim në një Palë tjetër Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shtet Anëtar. Autoriteti emërtues i Palës Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë që refuzon shërbimet e tregtimit do të hetojë vendimin dhe do të publikojë një opinion mbi mënyrën e heqjes së pengesave ndaj shërbimeve të tregtimit ose se si të përputhen shërbimet e tregtimit me rregullat e tregtimit.

8. Pala kontraktuese e Komunitetit të Energjisë ku është emërtuar NEMO do të sigurojë që emërtimi do të revokohet në rast se NEMO dështon të përmbushë detyrimet e përcaktuara në Nenin 6 dhe nuk është në gjendje të mundësojë përmbushjen e këtyre detyrimeve brenda gjashtë muajve nga njoftimi i dështimit nga autoriteti i emërtimit i Shtetit Anëtar ose Palës Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë. Nëse autoriteti rregullator nuk është përgjegjës për emërtimin dhe monitorimin e NEMO, ata do të konsultohen për revokimin. Autoriteti emërtues do të njoftojë gjithashtu autoritetin emërtues të Palës tjetër Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shtetit Anëtar në të cilat ai NEMO është aktiv për dështimin e tij për të ruajtur përputhshmërinë me kriteret e emërtimit, në të njëjtën kohë që njofton NEMO.

9. Nëse autoriteti i emërtimit i një Pale Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë konstaton se një NEMO aktiv, por që nuk është i emërtuar në vendin e tij, dështon të përmbushë detyrimet e përcaktuara në Nenin 6 në lidhje me shërbimet e tij në këtë vend, ai duhet të njoftojë NEMO për mos-përputhshmërinë e tij. Nëse NEMO nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet brenda tre muajve nga njoftimi për një dështim të tillë, autoriteti emërtues mund ti pezullojë të drejtën për të ofruar

shërbime të tregut të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, në këtë Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, deri në momentin kur NEMO të rivendosë përputhshmërinë. Autoriteti emërtues do të njoftojë gjithashtu autoritetin emërtues të Palës tjetër Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shtetit Anëtar ku është emërtuar NEMO, si dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë dhe Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se Shtetet Anëtare preken, Komisionin Evropian dhe Agjencinë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë.

10. Autoriteti i emërtimit do të njoftojë Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë për emërtimin dhe revokimin e NEMO-ve. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do të publikojë në faqen e tij të internetit një listë të NEMO-ve të emërtuara nga Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, statusin e tyre dhe vendin ku ato veprojnë.

## **Neni 5**

### **Emërtimi i NEMO-ve në rast të një monopoli ligjor kombëtar për shërbime tregtare**

1. Nëse, në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, në një Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose në zonën e ofertimit të Palës Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, ekziston një monopol ligjor kombëtar për shërbimet e tregut të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë që përjashton përcaktimin e më shumë se një NEMO, Pala përkatëse Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë duhet të njoftojë Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë brenda dy muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje dhe mund të refuzojë emërtimin e më shumë se një NEMO për zonë ofertimi.

Nëse ka disa aplikime për emërtimin si NEMO e vetme, Pala përkatëse Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë do të caktojë aplikuesin që plotëson më mirë kriteret e renditura në Nenin 6. Nëse një Palë Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë refuzon emërtimin e më shumë se një NEMO për një zonë ofertimi, autoriteti kompetent kombëtar do të caktojë ose miratojë tarifën e NEMO për tregtimin në tregun e ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë përpara hyrjes së tyre në fuqi, ose të specifikojë metodologjitë e përdorura për llogaritjen e tyre.

Në përputhje me Nenin 4(6), Pala përkatëse Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë mund të refuzojë gjithashtu shërbimet e tregtimit ndërkufitar të ofruara nga një NEMO i emërtuar nga një Palë tjetër Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë ose Shtet Anëtar; megjithatë, mbrojtja e bursave ekzistuese të energjisë në atë Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shtet Anëtar nga disavantazhet ekonomike nëpërmjet konkurrencës, nuk është një arsye e vlefshme për refuzim.

2. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, një monopol ligjor kombëtar ekziston në rastet kur ligji kombëtar përcakton shprehimisht emërtimin e një subjekti të vetëm për sigurimin e shërbimeve të tregut të ditës në avancë ose brenda së njëjtës ditë brenda një Pale Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose zonës së ofertimit të Palës Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë.

3. <...>

## **Neni 6**

### **Kriteret e emërtimit të NEMO**

1. Aplikuesi do të emërtohet si NEMO vetëm nëse i përmbush të gjitha kërkesat si më poshtë:

(a) ka kontraktuar ose kontraktuar burimet e përshtatshme për operimin e përbashkët, të koordinuar dhe të pajtueshëm të bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe/ose brenda së njëjtës ditë, përfshirë burimet e nevojshme për përmbushjen e funksioneve të NEMO, burimet financiare, teknologjinë informative të nevojshme, infrastrukturën teknike dhe procedurat e operimit ose duhet

të ofrojë dëshmi se është në gjendje që të vëri në dispozicion këto burime brenda një periudhe të arsyeshme përgatitore para se të fillojë detyrat e veta në përputhje me Nenin 7;

(b) duhet të jetë në gjendje që të sigurojë që pjesëmarrësit e tregut të kenë akses të hapur në informacion në lidhje me detyrat e NEMO në përputhje me Nenin 7;

(c) duhet të operojë me kosto efikente në lidhje me bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë dhe duhet që në kontabilitetin e brendshëm të ketë llogari të ndara për funksionet e Operatorit të Bashkimit të Tregut dhe aktivitetet e tjera në mënyrë që parandalojë ndër-subvencionimin;

(d) duhet të ketë nivel të duhur të ndarjes së biznesit nga pjesëmarrësit e tjerë të tregut;

(e) nëse do të emërtohet si një monopol ligjor kombëtar për shërbimet e tregut të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë në një Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, nuk do të përdorë tarifën e Nenit 5(1) për të financuar aktivitetet e veta të tregut të ditës në avancë ose brenda së njëjtës ditë në një Palë tjetër Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shtet Anëtar, përveç palës nga e cila ka marrë këto tarifa;

(f) duhet të trajtojë të gjithë pjesëmarrësit e tregut në mënyrë mosdiskriminuese;

(g) duhet të ketë miratuar marrëveshje të përshtatshme për mbikëqyrjen e tregut;

(h) duhet të ketë miratuar marrëveshje të përshtatshme për transparencë dhe konfidencialitet me pjesëmarrësit e tregut dhe OST-të;

(i) duhet të ofrojë shërbimet e nevojshme të klerimit dhe shlyerjes;

(j) duhet të vendosë sistemet e nevojshme të komunikimit dhe praktikën për koordinim me OST-të e Shtetit Anëtar dhe Palës Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë.

2. Kriteret e emërimit të përcaktuara në paragrafin 1 do të zbatohen në mënyrë të tillë që konkurrenca ndërmjet NEMO-ve të organizohet në mënyrë të barabartë dhe mosdiskriminuese.

## **Neni 7**

### **Detyrat e NEMO**

1. NEMO-t do të veprojnë si operatorë tregu në tregje kombëtare ose rajonale për të kryer, në bashkëpunim me OST-të, bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë. Detyrat e tyre do të përfshijnë pranimin e urdhërporosive nga pjesëmarrësit e tregut, duke pasur përgjegjësinë e plotë për përputhjen dhe alokimin e urdhërporosive në përputhje me rezultatet e bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, publikimin e çmimeve, klerimin dhe shlyerjen e kontratave që rezultojnë nga transaksionet sipas marrëveshjeve dhe rregulloreve relevante të pjesëmarrësve.

Në lidhje me bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, NEMO-t do të jenë në veçanti përgjegjës për detyrat në vijim:

(a) implementimin e funksioneve të OBT të përcaktuara në paragrafin 2 në koordinim me NEMO-t e tjerë;

(b) implementimin e kërkesave për bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, kërkesat për funksionet e OBT dhe algoritmin e çmimit të bashkimit mbi të gjitha çështjet e ndërlidhura me funksionimin e tregut të energjisë elektrike në përputhje me paragrafin 2 të këtij Neni dhe Nenin 36;

(c) implementimin e çmimeve maksimale dhe minimale në përputhje me Nenet 41 dhe 54;

(d) bërjen anonime dhe shpërndarjen e informacionit mbi urdhërporositë e pranuar, të nevojshme për të kryer funksionet e OBT të përmendura në paragrafin 2 të këtij Neni dhe Nenet 40 dhe 53;

(e) vlerësimin e rezultateve të llogaritura bazuar në funksionet e OBT të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij Neni, alokimin e urdhërporosive bazuar në këto rezultate, validimin e rezultateve si përfundimtare nëse ato konsiderohen si të sakta dhe duke marrë përgjegjësinë për to në përputhje me Nenet 48 dhe 60;

(f) informimin e pjesëmarrësve të tregut mbi rezultatet e urdhërporosive të tyre në përputhje me Nenet 48 dhe 60;

(g) të veprojë si kundërpalë qendrore për klerimin dhe shlyerjen e shkëmbimit të energjisë që rezulton nga bashkimi i tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë në përputhje me Nenin 68(3);

(h) të implementojë së bashku me NEMO-t dhe OST-të përkatëse procedurat rezervë për operimin e tregut kombëtar ose rajonal në përputhje me Nenin 36(3), nëse nuk ka rezultate në dispozicion nga funksionet e OBT në përputhje me Nenin 39(2), duke marrë parasysh procedurat alternative të parashikuara në Nenin 44;

(i) së bashku të vëri në dispozicion kostot e parashikuara dhe informacion mbi kostot për bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë për autoritetet kompetente rregullatore dhe OST-të në rastet ku kostot e NEMO për themelimin, ndryshimin dhe operimin e bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë do të mbuloen nga kontributet e OST-ve përkatëse, në përputhje me Nenet 75 deri 77 dhe Nenin 80;

(j) Aty ku është e mundur, në përputhje me Nenet 45 dhe 57, të koordinojë me OST-të për hartimin e marrëveshjeve në lidhje me operimin e më shumë se një NEMO brenda një zone ofertimi dhe të operojë bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe/ose brenda së njëjtës ditë në përputhje me marrëveshjet e miratuara.

2. NEMO-t mund të kryejnë funksionet e OBT së bashku me NEMO të tjera nga Shtete Anëtare. Këto funksione duhet të përfshijnë si më poshtë vijon:

(a) Zhvillimin, mirëmbajtjen dhe aplikimin e algoritmeve, sistemeve dhe procedurave për bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë në përputhje me Nenet 36 dhe 51;

(b) përpunimin e të dhënave hyrëse mbi kapacitetin ndër-zonal dhe kufizimet e alokimeve që ofrohen nga llogaritësit e kapacitetit të koordinuar në përputhje me Nenet 46 dhe 58;

(c) operimin e çmimeve të përbashkëta dhe algoritmeve të përputhjes së tregtimit të vazhdueshëm në përputhje me Nenet 48 dhe 60;

(d) validimin dhe dërgimin e rezultateve të bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë tek NEMO-t në përputhje me Nenet 48 dhe 60.



3. Brenda dymbëdhjetë muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të gjithë NEMO-t nga Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe Shtetet Anëtare do t'u paraqesin të gjitha autoriteteve rregullatore, Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, një plan për integrimin e NEMO-ve nga Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë në funksionet e OBT të përmendura në paragrafin 2, dhe në marrëveshjet ndërmjet NEMO-ve dhe palëve të treta. Ky plan do të jetë në harmoni me planin e hartuar në përputhje me Rregulloren e Komisionit (BE) 2015/1222 dhe do të përfshijë një përshkrim të detajuar dhe afatin kohor të propozuar për zbatim, dhe një përshkrim të ndikimit të pritshëm të këtij integrimi në performancën e funksioneve të OBT në Nenin 7 (2) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222.

4. Bashkëpunimi në mes NEMO-ve do të kufizohet vetëm në atë pjesë që është e nevojshme për hartimin, zbatimin dhe operimin eficient dhe të sigurtë të bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë. Performanca e përbashkët e funksioneve të OBT do të bazohet në parimin e mosdiskriminimit dhe do të sigurojë që asnjë NEMO të mos përfitojë nga avantazhet e paarsyeshme ekonomike përmes pjesëmarrjes në funksionet e OBT.

5. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do të monitorojë progresin e NEMO-ve në kryerjen e funksioneve të OBT në përputhje me paragrafin 2, veçanërisht në lidhje me kuadrin kontraktual dhe rregullator dhe me gatishmërinë teknike në përmbushjen e funksioneve të OBT.

6. <...>

## **Neni 8**

### **Detyrat e OST-ve lidhur me bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë**

1. Në Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë të lidhura në rrjet me Palë të tjera Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shtete Anëtare, të gjitha OST-të do të marrin pjesë në bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë.

2. OST-të do të:

(a) zbatojnë bashkërisht detyrimet e OST-ve për algoritmet e çmimit të tregut të përbashkët dhe të përputhjes së tregtimit të vazhdueshëm dhe për të gjitha aspektet që lidhen me alokimin e kapacitetit në përputhje me Nenin 37(1)(a) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222;

(b) <...>

(c) vendosin dhe kryejnë llogaritjen e kapacitetit në përputhje me Nenet 14 deri në 30;

(d) kur është e nevojshme, vendosin mbi alokimin e kapacitetit ndër-zonal dhe marrëveshjeve të tjera në përputhje me Nenet 45 dhe 57;

(e) llogarisin dhe dërgojnë kapacitetet ndër-zonale dhe kufizimet e alokimeve në përputhje me Nenet 46 dhe 58;

(f) verifikojnë rezultatet e bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë në lidhje me kapacitetet e validuara ndër-zonale dhe kufizimet e alokimeve në përputhje me Nenet 48(2) dhe 52;

(g) kur kërkohet, themelojnë llogaritës të shkëmbimeve të skeduluara për llogaritjen dhe publikimin e shkëmbimeve të skeduluara në kufijtë ndërmjet zonave të ofertimit në përputhje me Nenet 49 dhe 56;

(h) respektojnë rezultatet nga bashkimi i tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë të llogaritura në përputhje me Nenin 39 dhe Nenin 52;

(i) krijojnë dhe aplikojnë procedurat alternative të përshtatshme për alokimin e kapacitetit në përputhje me Nenin 44;

(j) zbatojnë kohën e hapjes së portës ndër-zonale për tregun brenda së njëjtës ditë dhe kohën e mbylljes së portës ndër-zonale për tregun brenda së njëjtës ditë në përputhje me Nenin 59;

(k) ndajnë të ardhurat e kongestionit në përputhje me metodologjinë e hartuar në përputhje me Nenin 73;

(l) aty ku është rënë dakord, veprojnë si agjentë transferimi për transferimin e pozicioneve neto në përputhje me Nenin 68(6).

## **Neni 9**

### **Miratimi i termave dhe kushteve apo metodologjive**

1. Kur kjo rregullore kërkon që OST-të dhe NEMO-t të hartojnë termat dhe kushtet apo metodologjitë, ata duhet ti paraqesin ato për miratim në Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë ose, në rast se Shtetet Anëtare preken, në Agjencinë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë ose autoritetet rregullatore kompetente, brenda afateve përkatëse të përcaktuara në këtë Rregullore. Në rrethana të jashtëzakonshme, veçanërisht në rastet kur një afat nuk mund të respektohet për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të OST-ve ose NEMO-ve, afatet për termat dhe kushtet apo metodologjitë mund të zgjaten bashkërisht nga të gjitha autoritetet rregullatore kompetente në procedurat sipas paragrafit 7, dhe nga autoriteti rregullator kompetent në procedurat sipas paragrafit 8.

Kur një propozim për terma dhe kushte apo metodologji në përputhje me këtë Rregullore duhet të hartohet dhe të miratohet nga më shumë se një OST ose NEMO, OST-të dhe NEMO-t pjesëmarrëse do të bashkëpunojnë ngushtë. OST-të, me ndihmën e ENTSO-E aty ku është e mundur, dhe të gjithë NEMO-t do të informojnë rregullisht autoritetet rregullatore kompetente, Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe Agjencinë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë mbi ecurinë për hartimin e këtyre termave dhe kushteve apo metodologjive.

2. <...>

3. Me përjashtim të Nenit 43(1), Nenit 44, Nenit 56(1), Nenit 63 dhe Nenit 74(1), ku OST-të që vendosin për propozimet për termat dhe kushtet apo metodologjitë e renditura në paragrafin 7 nuk janë në gjendje të arrijnë një marrëveshje dhe kur rajonet përkatëse përbëhen nga më shumë se pesë Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose Shtete Anëtare, ato do të vendosin me votim me shumicë të cilësuar. Shumica e cilësuar do të arrihet brenda secilës prej kategorive përkatëse të votave të OST-ve dhe NEMO-ve. Një shumicë e cilësuar për propozimet për termat dhe kushtet apo metodologjitë e renditura në paragrafin 7 do të kërkojë shumicën e mëposhtme:

(a) OST-të që përfaqësojnë të paktën 72 % të Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose Shteteve përkatëse Anëtare; dhe

(b) OST-të që përfaqësojnë Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose Shtete Anëtare që përbëjnë të paktën 65 % të popullsisë së rajonit përkatës.

Një pakicë bllokuese për vendimmarrjet mbi propozimet për termat dhe kushtet apo metodologjitë e renditura në paragrafin 7 duhet të përfshijë të paktën OST-të që përfaqësojnë më shumë se 35% të popullsisë së Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose të Shteteve Anëtare, plus OST-të që përfaqësojnë të paktën një Palë shtesë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose një Shtet Anëtar shtesë të ndikuar, përndryshe, shumica e cilësuar konsiderohet e arrirë.

OST-të që vendosin mbi propozimet për termat dhe kushtet apo metodologjitë e renditura në paragrafin 7 në lidhje me rajonet e përbëra nga pesë ose më pak Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose Shtete Anëtare, do të vendosin me konsensus.

Për vendimet e OST mbi propozimet për termat dhe kushtet apo metodologjitë e renditura në paragrafin 7, një votë do ti atribuohet çdo Pale Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shteti Anëtar. Nëse ka më shumë se një OST në territorin e një Pale Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose Shteti Anëtar, Shteti Anëtar do të ndajë kompetencat e votimit ndërmjet OST-ve.

NEMO-t që vendosin për propozimet për termat dhe kushtet apo metodologjitë e renditura në paragrafin 7 do të vendosin me konsensus.

4. Nëse OST-të ose NEMO-t dështojnë të paraqesin një propozim fillestar ose të ndryshuar për termat dhe kushtet apo metodologjitë tek autoritetet rregullatore kompetente ose Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë në përputhje me paragrafët 7, 8 ose 12 brenda afateve të përcaktuara në këtë Rregullore, do t'u ofrojnë autoriteteve rregullatore kompetente, Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, draftet me propozimet përkatëse për termat dhe kushtet apo metodologjitë, dhe të argumentojnë arsyen e pengesës së arritjes të marrëveshjes. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, duke vepruar në përputhje me Nenin 2 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC, të gjitha autoritetet rregullatore kompetente së bashku ose autoriteti rregullator kompetent, do të ndërmarrin hapat e nevojshme për miratimin e termave dhe kushteve apo metodologjive të kërkuara në përputhje me paragrafët 6, 7 dhe 8 respektivisht, përkatësisht duke kërkuar ndryshimin, rishikimin dhe plotësimin e drafteve në përputhje me këtë paragraf, përfshirë rastet kur nuk ka drafte të dorëzuara, dhe ti miratojnë ato.

5. Çdo autoritet rregullator, ose kur është e aplikueshme Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë duke vepruar në përputhje me Nenin 2 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC, sipas rastit, do të miratojë termat dhe kushtet apo metodologjitë e përdorura për llogaritjet ose krijimin e bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë zhvilluar nga OST-të dhe NEMO-t. Ato do të jenë përgjegjëse për miratimin e termave dhe kushteve apo metodologjive të përmendura në paragrafët 7 dhe 8. Përpara miratimit të këtyre termave dhe kushteve apo metodologjive, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë duke vepruar në përputhje me Nenin 2 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC ose autoritetet rregullatore kompetente, kur është e nevojshme, do të rishikojnë propozimet, pasi të konsultohen me OST-të ose NEMO-t përkatëse, në mënyrë që të sigurohen që ato janë në përputhje me qëllimin e kësaj Rregulloreje dhe në përputhje me Rregulloren e Komisionit (BE) 2015/1222 dhe kontribuojnë në integrimin e tregut, mosdiskriminimin, konkurrencën efektive dhe funksionimin e duhur të tregut.

6. OST-të dhe NEMO-t do të zbatojnë termat dhe kushtet apo metodologjitë e mëposhtme dhe çdo ndryshim i tyre do t'i nënshtrohet miratimit nga Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë:

(a) plani për implementimin e përbashkët të funksioneve të OBT në përputhje me Nenin 7(3);

(b) rajonet e llogaritjes së kapacitetit në përputhje me Nenin 15(1), kur rregullohen në përputhje me Nenin 1(2) të Shtojcës 1 të kësaj Rregulloreje;

(c) metodologjia e dërgimit të të dhënave mbi gjenerimin dhe ngarkesën në përputhje me Nenin 16(1) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222;

(d) metodologjia e modelit të përbashkët të rrjetit në përputhje me Nenin 17(1) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222;

(e) propozimi për një metodologji të harmonizuar të llogaritjes së kapacitetit në përputhje me Nenet 9(2), 9(6) dhe 21(4) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222;

(f) metodologjia rezervë në përputhje me Nenin 36(3) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222;

(g) algoritmi i paraqitur nga NEMO-t në përputhje me Nenin 37(5) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, përfshirë kërkesat e OST-ve dhe NEMO-ve për zhvillimin e algoritmit në përputhje me Nenin 37(1) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222;

(h) produktet që mund të merren në konsideratë nga NEMO-t në procesin e bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë në përputhje me Nenet 40(1) dhe 53(1) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222;

(i) çmimet maksimale dhe minimale në përputhje me Nenet 41(1) dhe 54(2) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222;

(j) metodologjia e çmimit të kapacitetit brenda së njëjtës ditë që do të hartohet në përputhje me Nenet 9(2), 9(6) dhe 55(1) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222;

(k) koha e hapjes së portës ndër-zonale brenda së njëjtës ditë dhe e mbylljes së portës ndër-zonale brenda së njëjtës ditë në përputhje me Nenin 59(1) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222;

(l) afati i pandryshueshmërisë të ditës në avancë në përputhje me Nenin 69 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222;

(m) metodologjia e shpërndarjes të të ardhurave nga kongjestioni në përputhje me Nenin 73(1) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222.

7. Propozimet për termat dhe kushtet apo metodologjitë e mëposhtme dhe çdo ndryshim i tyre do t'i nënshtrohen miratimit nga të gjitha autoritetet rregullatore të rajonit përkatës:

(a) metodologjia e përbashkët e llogaritjes së kapacitetit në përputhje me Nenin 20(2);

(b) vendimet për implementimin dhe shtyrjen e llogaritjes sipas metodologjisë të bazuar në flukse fizike në përputhje me Nenin 20(2) deri (6) dhe për përjashtimet në përputhje me Nenin 20(7);

(c) metodologjia për koordinimin e ridispeçimit dhe tregtimit me kah të kundërt në përputhje me Nenin 35(1);

(d) metodologjitë e përbashkëta për llogaritjen e shkëmbimeve të skeduluara në përputhje me Nenet 43(1) dhe 56(1);

(e) procedurat alternative në përputhje me Nenin 44;

(f) ankandet rajonale plotësuese në përputhje me Nenin 63(1);

(g) <...>

(h) metodologjia e ndarjes së kostove të ridispeçimit ose tregtimit me kah të kundërt në përputhje me Nenin 74(1).

8. Termat dhe kushtet ose metodologjitë e mëposhtme dhe çdo ndryshim i tyre do t'i nënshtrohen miratimit individual nga çdo autoritet rregullator ose autoritet tjetër kompetent i Palëve përkatëse Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë:

(a) aty ku është e aplikueshme, emërtimi dhe revokimi ose pezullimi i emërimit të NEMO në përputhje me Nenin 4(2), (8) dhe (9);

(b) në rast se janë të aplikueshme, tarifat ose metodologjitë e përdorura për llogaritjen e tarifave të NEMO-ve në lidhje me tregun e ditës në avancë ose brenda së njëjtës ditë në përputhje me Nenin 5(1);

(c) propozimet e OST-ve individuale për një rishikim të konfigurimit të zonës së ofertimit në përputhje me Nenin 32(1)(d);

(d) aty ku është e aplikueshme, propozimi për alokimin e kapacitetit ndër-zonal dhe marrëveshje të tjera në përputhje me Nenet 45 dhe 57;

(e) kostot për alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongestionit në përputhje me Nenet 75 deri në 79;

(f) nëse është e aplikueshme, ndarjen e kostove rajonale të bashkimit të tregut të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë në përputhje me Nenin 80(4).

9. Propozimi për termat dhe kushtet apo metodologjitë duhet të përfshijë një afat kohor për implementimin e tyre dhe një përshkrim të ndikimit të tyre të pritshëm në objektivat e kësaj Rregulloreje. Propozimet për termat dhe kushtet apo metodologjitë që i nënshtrohen miratimit nga disa autoritete rregullatore në përputhje me paragrafin 7, do t'i dorëzohen Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, që vepron në përputhje me Nenin 2 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC, brenda 1 jave nga dorëzimi i tyre tek autoritetet rregullatore. Propozimet për termat dhe kushtet apo metodologjitë që i nënshtrohen miratimit nga një autoritet rregullator në përputhje me paragrafin 8, mund t'i dorëzohen Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, që vepron në përputhje me Nenin 2 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MCEnC, brenda 1 muaji nga paraqitja e tyre, sipas gjykimit të autoritetit rregullator, ndërkohë ato që do të dorëzohen me kërkesë të Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë ose, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, duke vepruar në përputhje me Nenin 2 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC në rast se propozimi konsiderohet se ka një ndikim ndërkufitar. Me kërkesë të autoriteteve rregullatore kompetente, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, duke vepruar në përputhje me Nenin 2 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC do të dalë me një opinion brenda 3 muajve mbi propozimet për termat dhe kushtet apo metodologjitë.

10. Kur miratimi i termave dhe kushteve apo metodologjive në përputhje me paragrafin 7 ose ndryshimi në përputhje me paragrafin 12 kërkon një vendim nga më shumë se një autoritet rregullator, autoritetet rregullatore kompetente do të konsultohen, bashkëpunojnë ngushtë dhe koordinohen me njëri-tjetrin në mënyrë që të arrijnë një marrëveshje. Aty ku është e aplikueshme, autoritetet rregullatore kompetente do të marrin parasysh mendimin e Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, duke vepruar në përputhje me Nenin 2 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC. Autoritetet rregullatore ose, kur ka kompetencë, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, duke vepruar në përputhje me Nenin 2 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC do të marrë vendime në lidhje me termat dhe kushtet apo metodologjitë e paraqitura në përputhje me paragrafët 7 dhe 8, brenda 6 muajve pas marrjes së termave dhe kushteve apo metodologjive nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, duke vepruar në përputhje me Nenin 2 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC ose autoriteti rregullator ose, kur është e zbatueshme, nga autoriteti i fundit rregullator përkatës. Periudha fillon në ditën pasardhëse të ditës në të cilën propozimi është dorëzuar në përputhje me paragrafin 9 tek autoriteti i fundit rregullator përkatës në përputhje me paragrafin 7 ose, kur është e zbatueshme, tek autoriteti rregullator në përputhje me paragrafin 8.

11. Kur autoritetet rregullatore nuk kanë mundur të arrijnë marrëveshje brenda periudhës së përmendur në paragrafin 10, ose, me kërkesën e tyre të përbashkët, ose, me kërkesë të Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë ose, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, duke vepruar në përputhje me Nenin 2 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, duke vepruar në përputhje me Nenin 2 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC, brenda 6 muajve do të marrë një vendim në lidhje me propozimet e paraqitura për termat dhe kushtet ose metodologjitë.

12. Në rast se Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, ose të gjitha autoritetet rregullatore kompetente së bashku, ose autoriteti rregullator kompetent, kërkojnë një ndryshim për të miratuar termat dhe kushtet ose metodologjitë e paraqitura në përputhje me paragrafët 7 dhe 8 respektivisht, OST-të ose NEMO-t përkatëse do të paraqesin një propozim për termat dhe kushtet apo metodologjitë e ndryshuara për miratim brenda 2 muajve pas kërkesës nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë ose autoritetet rregullatore kompetente ose autoriteti rregullator kompetent. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë ose autoritetet rregullatore kompetente ose autoriteti rregullator kompetent do të vendosin për termat dhe kushtet apo metodologjitë e ndryshuara brenda 2 muajve pas dorëzimit të tyre. Kur autoritetet rregullatore kompetente nuk kanë arritur një marrëveshje mbi termat dhe kushtet apo metodologjitë, në përputhje me paragrafin 7, brenda afatit 2 mujor, ose me kërkesë të tyre të përbashkët, ose me kërkesë të Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë ose, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, duke vepruar në përputhje me Nenin 2 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC do të miratojë brenda 6 muajve një vendim në lidhje me termat dhe kushtet apo metodologjitë e ndryshuara. Nëse OST-të ose NEMO-t përkatëse dështojnë të paraqesin një propozim për termat dhe kushtet apo metodologjitë e ndryshuara, do të zbatohet procedura e parashikuar në paragrafin 4 të këtij neni.

13. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, duke vepruar në përputhje me Nenin 2 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC, ose të gjitha autoritetet rregullatore kompetente së bashku, ose autoriteti rregullator kompetent, aty ku ata janë përgjegjës për miratimin e termave dhe kushteve ose metodologjive në përputhje me paragrafët 7 dhe 8, mund të kërkojnë propozime përkatësisht për ndryshime të këtyre termave dhe kushteve apo metodologjive dhe të përcaktojnë një afat kohor për dorëzimin e këtyre propozimeve. OST-të ose NEMO-t përgjegjëse për hartimin e një propozimi për termat dhe kushtet apo metodologjitë mund t'u propozojnë ndryshime autoriteteve rregullatore dhe Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, duke vepruar në përputhje me Nenin 2 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC.

Propozimet për ndryshimin e termave dhe kushteve apo metodologjive i nënshtrohen konsultimit në përputhje me procedurën e përcaktuar në Nenin 12 dhe miratohen në përputhje me procedurën e përcaktuar në këtë nen.

14. OST-të dhe NEMO-t përgjegjëse për vendosjen e termave dhe kushteve apo metodologjive në përputhje me këtë Rregullore do t'i publikojnë ato në internet pas miratimit nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë ose autoritetet rregullatore kompetente ose, nëse nuk kërkohet një miratim i tillë, pas krijimit të tyre, përveç rasteve kur një informacion i tillë konsiderohet si konfidencial në përputhje me Nenin 13.

## **Neni 10**

### **Menaxhimi i përditshëm i bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë**

OST-të dhe NEMO-t do të kontribuojnë së bashku në organizimin e menaxhimit të përditshëm të bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë. Ata do të takohen rregullisht për të diskutuar dhe vendosur për çështjet e përditshme operative. OST-të dhe NEMO-t nga Shtete Anëtare që veprojnë në përputhje me Rregulloren e Komisionit (BE) 2015/1222 do të ftojnë Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë si vëzhgues në këto takime dhe do të publikojnë përmbledhje të procesverbaleve të takimeve.

## **Neni 11**

### **Përfshirja e palëve të interesuara**

Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, duke vepruar në përputhje me Nenin 2 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC, në bashkëpunim të ngushtë me ENTSO-E, do të organizojnë përfshirjen e palëve të interesuara në lidhje me bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë dhe aspekte të tjera të zbatimit të kësaj Rregulloreje. Kjo do të përfshijë takime të rregullta me palët e interesuara për të identifikuar problemet dhe për të propozuar përmirësime që lidhen veçanërisht me bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë. Kjo nuk do të zëvendësojë konsultimet e palëve të interesuara në përputhje me Nenin 12.

## **Neni 12**

### **Konsultime**

1. OST-të dhe NEMO-t përgjegjëse për paraqitjen e propozimeve për termat dhe kushtet apo metodologjitë ose ndryshimet e tyre në përputhje me këtë Rregullore, do të konsultohen me palët e

interesuara, duke përfshirë autoritetet përkatëse të secilës Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe Shteti Anëtar, për projekt propozimet për termat dhe kushtet apo metodologjitë të përcaktuara shprehimisht në këtë Rregullore. Konsultimi do të zgjasë për një periudhë jo më të shkurtër se një muaj.

2. Propozimet e paraqitura nga OST-të dhe NEMO-t në nivel rajonal do t'i nënshtrohen konsultimit të paktën në nivel rajonal. Palët që paraqesin propozime në nivel dypalësh ose shumëpalësh do të konsultohen të paktën me Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe Shtetet përkatëse Anëtare.

3. Subjektet përgjegjëse për propozimin për termat dhe kushtet apo metodologjitë do të marrin parasysh siç duhet pikëpamjet e palëve të interesuara që rezultojnë nga konsultimet e ndërmarra në përputhje me paragrafin 1, përpara paraqitjes së tyre për miratim rregullator nëse kërkohet në përputhje me Nenin 9 ose përpara publikimit në të gjitha rastet e tjera. Në të gjitha rastet, një justifikim i qartë dhe i plotë për përfshirjen ose jo të pikëpamjeve që rezultojnë nga konsultimi do të shtjellohet së bashku me materialin e dorëzuar dhe do të publikohet në kohën e duhur, përpara ose njëkohësisht me publikimin e propozimit për termat dhe kushtet apo metodologjitë.

### **Neni 13**

#### **Detyrimet e konfidencialitetit**

1. Çdo informacion konfidencial i marrë, i shkëmbyer ose i transmetuar në përputhje me këtë Rregullore do t'i nënshtrohet kushteve të sekretit profesional të përcaktuara në paragrafët 2, 3 dhe 4.

2. Detyrimi i sekretit profesional zbatohet për çdo person që i nënshtrohet dispozitave të kësaj Rregulloreje.

3. Informacioni konfidencial i marrë nga personat e përmendur në paragrafin 2 gjatë kryerjes së detyrave të tyre nuk mund t'i transmetohet asnjë personi ose autoriteti tjetër, pa paragjykuar rastet e përcaktuara në ligjin kombëtar, dispozitat e tjera të kësaj Rregulloreje apo ndonjë legjislacioni tjetër përkatës të Komunitetit të Energjisë ose kombëtar.

4. Pa paragjykuar rastet e përcaktuara në ligjin kombëtar, autoritetet rregullatore, organet ose personat që marrin informacion konfidencial në përputhje me këtë Rregullore, mund ta përdorin atë vetëm për qëllimin e kryerjes së funksioneve të tyre sipas kësaj Rregulloreje.

## **TITULLI II**

### **KËRKESAT PËR TERMAT, KUSHTET DHE METODOLOGJITË LIDHUR ME ALOKIMIN E KAPACITETIT DHE MENAXHIMIN E KONGJESTIONIT**

#### **KAPITULLI 1**

##### **Llogaritja e kapacitetit**

##### **Seksioni 1**

##### **Dispozita të përgjithshme**

#### **Neni 14**

##### **Afatet kohore të llogaritjes së kapacitetit**

1. Të gjitha OST-të do të llogarisin kapacitetin ndër-zonal për të paktën afatet kohore të mëposhtme:



(a) ditën përpara, për tregun e ditës në avancë;

(b) brenda ditës, për tregun brenda së njëjtës ditë.

2. Për afatin e tregut të ditës në avancë do të llogariten vlerat individuale për kapacitetin ndër-zonal për çdo njësi kohore të tregut të ditës në avancë. Për afatin e tregut brenda së njëjtës ditë do të llogariten vlerat individuale për kapacitetin ndër-zonal për çdo njësi kohore të mbetur të tregut brenda së njëjtës ditë.

3. Për afatin kohor të tregut të ditës në avancë, llogaritja e kapacitetit do të bazohet në informacionin më të fundit të disponueshëm. Përditësimi i informacionit për afatin e tregut të ditës në avancë nuk do të fillojë para orës 15:00 të kohës së tregut, dy ditë para ditës së livrimit.

4. Të gjitha OST-të në çdo rajon të llogaritjes së kapacitetit siç përcaktohet në Nenin 15(1) duhet të sigurohen që kapaciteti ndër-zonal të rillogaritet brenda afatit kohor të tregut brenda së njëjtës ditë bazuar në informacionin më të fundit të disponueshëm. Frekuenca e kësaj rillogaritjeje do të marrë në konsideratë efikasitetin dhe sigurinë e operimit.

## **Neni 15**

### **Rajonet e llogaritjes së kapacitetit**

1. Rajonet e llogaritjes së kapacitetit duke përfshirë Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe Shtetet Anëtare (për interkoneksionet e tyre me Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë) përcaktohen në Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje.

2. Shtojca 1 do të përcaktojë kufijtë e zonës së ofertimit të OST-ve që janë anëtare të çdo rajoni të llogaritjes së kapacitetit. Për këtë duhet të plotësohen kërkesat e mëposhtme:

(a) marrja parasysh e rajoneve të llogaritjes së kapacitetit të përcaktuara në përputhje me Nenin 15(1) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222;

(b) çdo kufi i zonës së ofertimit, ose dy kufij të veçantë të zonës së ofertimit nëse është e zbatueshme, ku ka linjë interkoneksioni ndërmjet dy zonave të ofertimit, do t'i caktohet një rajoni të llogaritjes së kapacitetit;

(c) të paktën këto OST do t'u caktohen të gjithë rajoneve të llogaritjes së kapacitetit në të cilat ato kanë kufijtë e zonave të ofertimit.

3. Rajonet e llogaritjes së kapacitetit themeluar në bazë të kësaj Rregulloreje ose në përputhje me Nenin 15(1) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 që aplikojnë metodologjinë e bazuar në flukse fizike, do të shkrihen në një rajon të llogaritjes së kapacitetit nëse plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e mëposhtme:

(a) sistemet e tyre të transmetimit janë të lidhura drejtpërdrejtë me njëri-tjetrin;

(b) marrin pjesë në të njëjtën zonë të bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë ose brenda së njëjtës ditë;

(c) bashkimi i tyre është më eficient sesa mbajtja e tyre të ndara. Autoritetet rregullatore kompetente mund të kërkojnë një analizë të përbashkët kosto-përfitim nga OST-të përkatëse për të vlerësuar efikasitetin e bashkimit.

## **Seksioni 2**

### **Modeli i përbashkët i rrjetit**

#### **Neni 16**

##### **Metodologjia e dërgimit të të dhënave mbi gjenerimin dhe ngarkesën**

1. <...>

2. Metodologjia e dërgimit të të dhënave mbi gjenerimin dhe ngarkesën duhet të specifikojë ato njësi gjeneruese dhe të ngarkesës të cilat duhet t'u dërgojnë informacion OST-ve të tyre përkatëse për qëllime të llogaritjes së kapacitetit.

3. <...>

4. Metodologjia do të specifikojë afatet që aplikohen për njësitë gjeneruese dhe të ngarkesës për dhënien e informacionit përcaktuar në paragrafin 5.

5. Për aplikimin e metodologjisë së dërgimit të të dhënave mbi gjenerimin dhe ngarkesën, çdo OST do të përdorë dhe do të ndajë me OST-të e tjera të paktën informacionin e mëposhtëm:

(a) informacion në lidhje me karakteristikat e tyre teknike;

(b) informacion në lidhje me disponueshmërinë e njësive gjeneruese dhe të ngarkesës;

(c) informacion në lidhje me skedulimet e njësive gjeneruese;

(d) informacionin përkatës të disponueshëm në lidhje me mënyrën e dispeçimit të njësive gjeneruese.

Ky informacion do të përdoret vetëm për qëllime të llogaritjes së kapacitetit.

6. Jo më vonë se tetë muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, ENTSO-E, duke vepruar në përputhje me Nenin 3 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC do të publikojë:

(a) një listë të subjekteve që duhet t'i dërgojnë informacion OST-ve;

(b) një listë të informacionit që do të jepet, të përmendur në paragrafin 5;

(c) afatet për dhënien e informacionit.

#### **Neni 17**

##### **Metodologjia e modelit të përbashkët të rrjetit**

<...>

#### **Neni 18**

##### **Skenarët**

1. OST-të do të zbatojnë skenarët e përbashkët për çdo afat kohor të llogaritjes së kapacitetit të përmendur në Nenin 14(1)(a) dhe (b) të hartuar në përputhje me Nenin 18(1) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222.

2. OST-të do të zbatohen rregullat e përbashkëta të hartuara në përputhje me Nenin 18(3) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 për përcaktimin e pozicionit neto në secilën zonë ofertimi dhe fluksit për secilën linjë me rrymë të vazhduar.

### **Neni 19**

#### **Modeli individual i rrjetit**

1. Për secilën zonë ofertimi dhe për secilin skenar:

(a) të gjitha OST-të në zonën e ofertimit do të ofrojnë së bashku një model individual të vetëm të rrjetit i cili duhet të jetë në përputhje me Nenin 18(3) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222; ose

(b) çdo OST në zonën e ofertimit do të ofrojë një model individual të rrjetit për zonën e tij të kontrollit, duke përfshirë interkoneksionet, me kusht që shumica e pozicioneve neto në zonat e kontrollit duke përfshirë interkoneksionet që mbulojnë zonën e ofertimit, të jetë në përputhje me Nenin 18(3) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222.

2. Çdo model individual i rrjetit do të përfaqësojë parashikimin më të mirë të mundshëm të kushteve të sistemit të transmetimit për secilin skenar të specifikuar nga OST-të në kohën e krijimit të modelit individual të rrjetit.

3. Modelet individuale të rrjetit do të mbulojnë të gjithë elementët e rrjetit të sistemit të transmetimit që përdoren në analizën rajonale të sigurisë së operimit për afatin kohor përkatës.

4. Të gjitha OST-të duhet të harmonizojnë në maksimumin e mundshëm mënyrën me të cilën janë ndërtuar modelet individuale të rrjetit.

5. Çdo OST do të sigurojë të gjitha të dhënat e nevojshme në modelin individual të rrjetit për të lejuar analizat e fluksit të fuqisë aktive dhe reaktive dhe të tensionit në gjendje të qëndrueshme.

6. Kur është e përshtatshme, dhe me marrëveshje ndërmjet të gjitha OST-ve brenda një rajoni të llogaritjes së kapacitetit, çdo OST në atë rajon të llogaritjes së kapacitetit do të shkëmbejë të dhëna ndërmjet njëri-tjetrit për të mundësuar analizat e tensionit dhe stabilitetit dinamik.

### **Seksioni 3**

#### **Metodologjitë e llogaritjes së kapacitetit**

### **Neni 20**

#### **Prezantimi i metodologjisë së llogaritjes të kapacitetit bazuar në flukse fizike**

1. Për afatin kohor të tregut të ditës në avancë dhe për afatin kohor të tregut brenda së njëjtës ditë, qasja e përdorur në metodologjitë e përbashkëta të llogaritjes së kapacitetit do të jetë një metodologji e bazuar në flukse fizike, përveç rasteve kur kërkesa sipas paragrafit 7 plotësohet.

2. Jo më vonë se 6 muaj pas krijimit të një rajoni për llogaritjen e kapacitetit në përputhje me Shtojcën I, të gjitha OST-të në çdo rajon të llogaritjes së kapacitetit do të paraqesin një propozim për një metodologji të përbashkët të koordinuar të llogaritjes së kapacitetit brenda rajonit përkatës. Propozimi do t'i nënshtrohet konsultimeve në përputhje me Nenin 12. Propozimi duhet të përafrohet me metodologjinë e llogaritjes së kapacitetit të zbatueshme në rajonet fqinje të llogaritjes së kapacitetit.

3. <...>

4. Jo më vonë se gjashtë muaj pasi të paktën të gjitha Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë të Evropës Juglindore të marrin pjesë në bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë, OST-të nga këto Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë së bashku me OST-të nga të paktën Kroacia, Rumania, Bullgaria, Hungaria dhe Greqia, do të paraqesin bashkërisht një propozim për të prezantuar një metodologji të përbashkët të llogaritjes së kapacitetit duke përdorur metodologjinë e bazuar në flukse fizike, për afatin kohor të tregut të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë. Propozimi do të parashikojë një datë zbatimi të metodologjisë së përbashkët të llogaritjes së kapacitetit duke përdorur metodologjinë e bazuar në flukse fizike jo më vonë se dy vjet pas pjesëmarrjes së të gjitha Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë të EJL në bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë. OST-të nga Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë që kanë kufij me rajone të tjera inkurajohen t'i bashkohen iniciativave për të zbatuar me këto rajone një metodologji të përbashkët të llogaritjes së kapacitetit të bazuar në flukse fizike.

5. Në kohën kur dy ose më shumë rajone kufitare të llogaritjes së kapacitetit në të njëjtën zonë sinkrone zbatojnë një metodologji të llogaritjes së kapacitetit bazuar në flukse fizike për afatin kohor të tregut të ditës në avancë ose brenda së njëjtës ditë, për këtë qëllim, do të konsiderohen si një rajon, dhe OST-të nga ky rajon do të paraqesin brenda gjashtë muajve një propozim për aplikimin e një metodologjie të përbashkët të llogaritjes së kapacitetit bazuar në flukse fizike për afatin kohor të tregut të ditës në avancë ose brenda së njëjtës ditë. Propozimi do të parashikojë një datë të implementimit të metodologjisë së përbashkët ndër-rajonale të llogaritjes së kapacitetit jo më shumë se 12 muaj pas zbatimit të metodologjisë të bazuar në flukse fizike në këto rajone për afatin kohor të tregut të ditës në avancë, dhe 18 muaj për metodologjinë për afatin kohor të tregut brenda së njëjtës ditë. Afatet kohore të shprehura në këtë paragraf mund të përshtaten në përputhje me paragrafin 6.

Metodologjia në dy rajonet e llogaritjes së kapacitetit që kanë filluar të hartojnë një metodologji të përbashkët të llogaritjes së kapacitetit mund të implementohet para se të hartohet metodologjia e përbashkët e llogaritjes së kapacitetit me rajone të tjera të llogaritjes së kapacitetit.

6. Nëse OST-të përkatëse janë në gjendje të dëshmojnë se aplikimi i metodologjive të përbashkëta të bazuara në flukse fizike në përputhje me paragrafët 4 dhe 5 nuk do të ishte më eficient duke supozuar të njëjtin nivel të sigurisë së operimit, ata së bashku mund t'i kërkojnë autoriteteve rregullatore kompetente shtyrjen e afateve.

7. OST-të mund t'i kërkojnë së bashku autoriteteve rregullatore kompetente që të zbatojnë në rajon dhe në kufijtë e zonës së ofertimit metodologjinë e kapacitetit të koordinuar neto të transmetimit, nëse OST-të përkatëse janë në gjendje të dëshmojnë se aplikimi i metodologjisë të llogaritjes së kapacitetit bazuar në flukse fizike nuk do të ishte më eficient në krahasim me metodologjinë e kapacitetit të koordinuar neto të transmetimit dhe duke supozuar të njëjtin nivel të sigurisë së operimit në rajonin përkatës.

8. Për t'u mundësuar pjesëmarrësve të tregut që të përshtaten me çdo ndryshim në metodologjinë e llogaritjes së kapacitetit, OST-të përkatëse do të testojnë metodologjinë e re krahas metodologjisë ekzistuese dhe do të përfshijnë pjesëmarrësit e tregut në testime për të paktën gjashtë muaj përpara se të implementojnë propozimin për ndryshimin e metodologjisë së tyre të llogaritjes së kapacitetit.

9. OST-të e secilit rajon të llogaritjes së kapacitetit që aplikojnë metodologjinë e bazuar në flukse fizike do të krijojnë dhe vënë në dispozicion një instrument që u mundëson pjesëmarrësve të tregut të vlerësojnë ndërveprimin ndërmjet kapaciteteve ndër-zonale dhe shkëmbimeve ndër-zonale ndërmjet zonave të ofertimit.

## Neni 21

### Metodologjia e llogaritjes së kapacitetit

1. Propozimi për një metodologji të përbashkët të llogaritjes së kapacitetit për një rajon të llogaritjes së kapacitetit përcaktuar në përputhje me Nenin 20(2) do të përfshijë të paktën elementët e mëposhtëm për çdo afat kohor të llogaritjes së kapacitetit:

(a) metodologjitë për përlllogaritjen e inputeve për llogaritjen e kapacitetit, të cilat do të përfshijnë parametrat e mëposhtëm:

(i) një metodologji për përcaktimin e margjinës së besueshmërisë në përputhje me Nenin 22;

(ii) metodologjitë për përcaktimin e kufijve të sigurisë së operimit, kontigjencat përkatëse për llogaritjen e kapacitetit dhe kufizimet e alokimit që mund të zbatohen në përputhje me Nenin 23;

(iii) metodologjinë për përcaktimin e faktorëve të zhvendosjes së gjenerimit në përputhje me Nenin 24;

(iv) metodologjinë për përcaktimin e veprimeve përmirësuese që duhet të merren parasysh në llogaritjen e kapacitetit në përputhje me Nenin 25.

(b) një përshkrim të detajuar të metodës së llogaritjes të kapacitetit, i cili do të përfshijë sa vijon:

(i) një përshkrim matematikor të metodës së aplikuar për llogaritjen e kapacitetit me inpute të ndryshme të llogaritjes së kapacitetit;

(ii) rregullat për shmangien e diskriminimit të padrejtë ndërmjet shkëmbimeve të brendshme dhe ndër-zonale për të garantuar përputhshmërinë me Nenin 16(9) të Rregullores (BE) 2019/943, siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Këshillit Ministeror 2002/03/MC-EnC;

(iii) rregullat për marrjen parasysh, aty ku është e përshtatshme, të kapacitetit ndër-zonal të alokuar më parë;

(iv) rregullat për përshtatjen e flukseve të energjisë në elementët kritikë të rrjetit ose të kapacitetit ndër-zonal për shkak të veprimeve përmirësuese në përputhje me Nenin 25;

(v) për metodologjinë e bazuar në flukse fizike, një përshkrim matematikor të llogaritjes së faktorëve të shpërndarjes së transferimit të energjisë dhe të llogaritjes të margjinave të disponueshme në elementët kritikë të rrjetit;

(vi) për metodologjinë e kapacitetit të koordinuar neto të transmetimit, rregullat për llogaritjen e kapacitetit ndër-zonal, duke përfshirë rregullat për ndarjen në mënyrë eficiente të mundësive të flukseve të energjisë në elementët kritikë të rrjetit ndërmjet zonave të ndryshme të ofertimit;

(vii) kur flukset e energjisë në elementët kritikë të rrjetit ndikohen nga shkëmbimet ndër-zonale të energjisë në rajone të ndryshme të llogaritjes së kapacitetit, rregullat për ndarjen e mundësive të flukseve të energjisë në elementët kritikë të rrjetit ndërmjet rajoneve të ndryshme të llogaritjes së kapacitetit në mënyrë që të akomodohen këto flukse.

(c) një metodologji për validimin e kapacitetit ndër-zonal në përputhje me Nenin 26.

2. Për afatin kohor të llogaritjes së kapacitetit brenda së njëjtës ditë, metodologjia e llogaritjes së kapacitetit duhet të përfshijë gjithashtu frekuencën në të cilën kapaciteti do të rivlerësohet në përputhje me Nenin 14(4), duke dhënë arsyet për frekuencën e zgjedhur.

3. Metodologjia e llogaritjes së kapacitetit duhet të përfshijë një procedurë alternative për rastin kur llogaritja fillestare e kapacitetit nuk prodhon ndonjë rezultat.

4. Të gjitha OST-të në çdo rajon të llogaritjes së kapacitetit, për aq sa është e mundur, do të përdorin të dhëna të harmonizuara të llogaritjes së kapacitetit.

## **Neni 22**

### **Metodologjia e margjinës së besueshmërisë**

1. Propozimi për një metodologji të përbashkët të llogaritjes së kapacitetit duhet të përfshijë një metodologji për të përcaktuar margjinën e besueshmërisë. Metodologjia për të përcaktuar margjinën e besueshmërisë do të përbëhet nga dy hapa. Së pari, OST-të përkatëse do të vlerësojnë shpërndarjen e probabilitetit të devijimeve ndërmjet flukseve të pritshme të energjisë në kohën e llogaritjes së kapacitetit dhe flukseve të realizuara të energjisë në kohë reale. Së dyti, margjina e besueshmërisë do të llogaritet duke nxjerrë një vlerë nga shpërndarja e probabilitetit.

2. Metodologjia për përcaktimin e margjinës së besueshmërisë do të përcaktojë parimet për llogaritjen e shpërndarjes së probabilitetit të devijimeve ndërmjet flukseve të pritshme të energjisë në momentin e llogaritjes së kapacitetit dhe flukseve të realizuara të energjisë në kohë reale, dhe do të specifikojë pasiguritë që duhen marrë në konsideratë në llogaritje. Për të përcaktuar këto pasiguri, metodologjia në veçanti do të marrë parasysh:

(a) devijimet e paqëllimta të flukseve fizike të energjisë elektrike brenda një afati kohor të tregut të shkaktuara nga rregullimi i flukseve të energjisë elektrike brenda dhe ndërmjet zonave të kontrollit, për të mbajtur një frekuencë konstante;

(b) pasiguritë që mund të ndikojnë në llogaritjen e kapacitetit dhe që mund të ndodhin ndërmjet afatit kohor të llogaritjes së kapacitetit dhe kohës reale, për njësinë përkatëse të kohës së tregut.

3. Në metodologjinë për përcaktimin e margjinës të besueshmërisë, OST-të do të përcaktojnë gjithashtu parime të përbashkëta të harmonizuara për përcaktimin e margjinës së besueshmërisë nga shpërndarja e probabilitetit.

4. Mbi bazën e metodologjisë së miratuar në përputhje me paragrafin 1, OST-të do të përcaktojnë margjinën e besueshmërisë duke respektuar kufijtë e sigurisë së operimit dhe duke marrë parasysh pasiguritë ndërmjet afatit kohor të llogaritjes së kapacitetit dhe kohës reale, dhe veprimeve përmirësuese të disponueshme pas llogaritjes së kapacitetit.

5. Për çdo afat kohor të llogaritjes së kapacitetit, OST-të përkatëse do të përcaktojnë margjinën e besueshmërisë për elementët kritik të rrjetit, kur metodologjia e bazuar në flukse fizike zbatohet, dhe për kapacitetin ndër-zonal, kur metodologjia e kapacitetit të koordinuar neto të transmetimit zbatohet.

## **Neni 23**

### **Metodologjitë për kufijtë e sigurisë së operimit, kontigjencat dhe kufizimet e alokimit**

1. Çdo OST do të respektojë kufijtë e sigurisë së operimit dhe kontigjencave të përcaktuara në analizën e sigurisë së operimit.

2. Nëse kufijtë e sigurisë së operimit dhe kontigjencat të përdorura në llogaritjen e kapacitetit nuk janë të njëjta me ato të përdorura në analizën e sigurisë së operimit, OST-të duhet të përshkruajnë në propozimin për metodologjinë e përbashkët të llogaritjes së kapacitetit metodën dhe kriteret e veçanta që kanë përdorur për të përcaktuar kufijtë e sigurisë së operimit dhe kontigjencat që kanë përdorur për llogaritjen e kapacitetit.

3. Nëse OST-të zbatojnë kufizime të alokimit, ato mund të përcaktohen vetëm duke përdorur:

(a) kufizimet që nevojiten për të mbajtur sistemin e transmetimit brenda kufijve të sigurisë së operimit dhe që nuk mund të transformohen në mënyrë eficiente në flukse maksimale në elementët kritikë të rrjetit; ose

(b) kufizimet që synojnë të rrisin tepriçen ekonomike për bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë ose brenda së njëjtës ditë.

## **Neni 24**

### **Metodologjia e faktorëve të zhvendosjes së gjenerimit**

1. Propozimi për një metodologji të përbashkët të llogaritjes së kapacitetit përfshin një propozim për një metodologji për përcaktimin e një faktori të përbashkët të zhvendosjes së gjenerimit për çdo zonë ofertimi dhe skenar, zhvilluar në përputhje me Nenin 18.

2. Faktorët e zhvendosjes së gjenerimit do të përfaqësojnë parashikimin më të mirë në lidhje me një ndryshim në pozicionin neto të një zone ofertimi me një ndryshim specifik të gjenerimit ose ngarkesës në modelin e përbashkët të rrjetit. Ky parashikim do të marrë parasysh veçanërisht informacionin nga metodologjia e dërgimit të të dhënave mbi gjenerimin dhe ngarkesën.

## **Neni 25**

### **Metodologjia për veprime përmirësuese në llogaritjen e kapacitetit**

1. Çdo OST brenda çdo rajoni të llogaritjes së kapacitetit do të përcaktojë individualisht veprimet përmirësuese të disponueshme që duhet të merren parasysh në llogaritjen e kapacitetit për të përmbushur objektivat e kësaj Rregulloreje.

2. Çdo OST brenda çdo rajoni të llogaritjes së kapacitetit do të koordinojë me OST-të e tjera në atë rajon përdorimin e veprimeve përmirësuese që duhet të merren parasysh në llogaritjen e kapacitetit dhe zbatimin e tyre në operimin në kohë reale.

3. Për të mundësuar që veprimet përmirësuese të merren parasysh në llogaritjen e kapacitetit, të gjitha OST-të në çdo rajon të llogaritjes së kapacitetit do të bien dakord për përdorimin e veprimeve përmirësuese që kërkojnë veprimin e më shumë se një OST.

4. Çdo OST do të sigurojë që veprimet përmirësuese të merren parasysh në llogaritjen e kapacitetit me kusht që veprimet përmirësuese të disponueshme të mbetura pas llogaritjes, duke përfshirë margjinën e besueshmërisë të përmendur në Nenin 22, të jenë të mjaftueshme për të garantuar sigurinë e operimit.

5. Çdo OST do të marrë parasysh veprime përmirësuese pa kosto në llogaritjen e kapacitetit.

6. Çdo OST do të sigurojë që veprimet përmirësuese që do të merren parasysh në llogaritjen e kapacitetit janë të njëjta për të gjitha afatet kohore të llogaritjes së kapacitetit, duke marrë parasysh disponueshmërinë e tyre teknike për secilin afat kohor të llogaritjes së kapacitetit.

## **Neni 26**

### **Metodologjia e validimit të kapacitetit ndër-zonal**

1. Çdo OST do të validojë dhe do të ketë të drejtën të korrigjojë kapacitetin ndër-zonal të zonës së ofertimit të OST-së përkatëse ose elementët kritik të rrjetit të ofruara nga llogaritësit e kapacitetit të koordinuar në përputhje me Nenet 27 deri në 31.
2. Kur zbatohet metodologjia e kapacitetit të koordinuar neto të transmetimit, të gjitha OST-të në rajonin e llogaritjes së kapacitetit do të përfshijnë në metodologjinë e llogaritjes së kapacitetit të përmendur në Nenin 21, një rregull për ndarjen e korrigjimit të kapacitetit ndër-zonal ndërmjet kufijve të zonave të ndryshme të ofertimit.
3. Çdo OST, për arsye të sigurisë së operimit, mund të reduktojë kapacitetin ndër-zonal gjatë validimit të kapacitetit ndër-zonal të përmendur në paragrafin 1.
4. Çdo llogaritës i kapacitetit të koordinuar duhet të koordinohet me llogaritësit fqinjë të kapacitetit të koordinuar gjatë llogaritjes dhe validimit të kapacitetit.
5. Çdo llogaritës i kapacitetit të koordinuar do të raportojë, çdo tre muaj, të gjitha reduktimet e bëra gjatë validimit të kapacitetit ndër-zonal në përputhje me paragrafin 3, tek të gjitha autoritetet rregullatore të rajonit të llogaritjes së kapacitetit. Ky raport do të përfshijë vendndodhjen dhe shumën e çdo reduktimi në kapacitetin ndër-zonal dhe do të japë arsyet për reduktimet.
6. Të gjitha autoritetet rregullatore të rajonit të llogaritjes së kapacitetit vendosin nëse do të publikojnë të gjithë ose një pjesë të raportit të përmendur në paragrafin 5.

## **Seksioni 4**

### **Procesi i llogaritjes së kapacitetit**

## **Neni 27**

### **Dispozita të përgjithshme**

1. <...>
2. Jo më vonë se gjashtë muaj pas krijimit të rajoneve të llogaritjes së kapacitetit të përmendura në Nenin 15(1), të gjitha OST-të në secilin rajon të llogaritjes së kapacitetit do të krijojnë së bashku llogaritësit e kapacitetit të koordinuar dhe do të miratojnë rregulla që drejtojnë funksionimin e tyre.
3. Të gjitha OST-të e çdo rajoni të llogaritjes së kapacitetit do të rishikojnë çdo dy vjet cilësinë e të dhënave të paraqitura në kuadër të llogaritjes së kapacitetit, si pjesë e raportit dyvjeçar për llogaritjen dhe alokimin e kapacitetit hartuar në përputhje me Nenin 31.
4. Duke përdorur informacionin më të fundit të disponueshëm, të gjitha OST-të duhet të rishikojnë dhe përditësojnë rregullisht dhe të paktën një herë në vit:
  - (a) kufijtë e sigurisë së operimit, kontigjencat dhe kufizimet e alokimit të përdorura për llogaritjen e kapacitetit;
  - (b) shpërndarjen e probabilitetit të devijimeve ndërmjet flukseve të pritshme të energjisë në kohën e llogaritjes së kapacitetit dhe flukseve të realizuara të energjisë në kohë reale, të përdorura për llogaritjen e marginave të besueshmërisë;



(c) veprimet përmirësuese të marra parasysht në llogaritjen e kapacitetit;

(d) aplikimin e metodologjive për përcaktimin e faktorëve të zhvendosjes së gjenerimit, elementëve kritike të rrjetit dhe kontigjencave të përmendura në Nenin 22 deri në 24.

## **Neni 28**

### **Bashkimi në modelin e përbashkët të rrjetit**

1. Për çdo afat kohor të llogaritjes së kapacitetit të përmendur në Nenin 14(1), çdo njësi gjeneruese ose ngarkese subjekt i Nenit 16 do të japë të dhënat e specifikuar në metodologjinë e dërgimit të të dhënave mbi gjenerimin dhe ngarkesën OST-së përgjegjëse për zonën përkatëse të kontrollit brenda afateve të përcaktuara.

2. Çdo njësi gjeneruese ose ngarkese që ofron informacion në përputhje me Nenin 16(5) do të dërgojë të dhënat më të besueshme të mundshme të parashikimeve.

3. Për çdo afat kohor të llogaritjes së kapacitetit, çdo OST do të krijojë modelin individual të rrjetit për secilin skenar në përputhje me Nenin 19, në mënyrë që të bashkojë modelet individuale të rrjetit në një model të përbashkët të rrjetit.

4. Çdo OST do t'i dorëzojë OST-ve përgjegjëse për bashkimin e modeleve individuale të rrjetit në një model të përbashkët rrjeti, të dhënat më të besueshme të mundshme të parashikimeve për secilin model individual të rrjetit.

5. Për çdo afat kohor të llogaritjes së kapacitetit krijohet një model i vetëm i përbashkët i rrjetit siç parashikohet në Nenin 9(6)(d).

## **Neni 29**

### **Llogaritja rajonale e kapacitetit ndër-zonal**

1. Për çdo afat kohor të llogaritjes së kapacitetit, çdo OST duhet t'i sigurojë llogaritësve të kapacitetit të koordinuar dhe të gjitha OST-ve të tjera në rajonin e llogaritjes së kapacitetit elementët e mëposhtëm: kufijtë e sigurisë së operimit, faktorët e zhvendosjes së gjenerimit, veprimet përmirësuese, margjinat e besueshmërisë, kufizimet e alokimit dhe kapacitetin ndër-zonal të alokuar më parë.

2. Çdo llogaritës i kapacitetit të koordinuar do të kryejë një analizë të sigurisë së operimit duke zbatuar kufijtë e sigurisë së operimit nëpërmjet përdorimit të modelit të përbashkët të rrjetit krijuar për secilin skenar në përputhje me Nenin 28(5).

3. Gjatë llogaritjes së kapacitetit ndër-zonal, çdo llogaritës i kapacitetit të koordinuar duhet:

(a) të përdorë faktorët e zhvendosjes së gjenerimit për të llogaritur ndikimin e ndryshimeve në pozicionet neto të zonës së ofertimit dhe flukseve në linjat me rrymë të vazhduar;

(b) të injorojë ata elementë kritikë të rrjetit që nuk ndikohen ndjeshëm nga ndryshimet në pozicionet neto të zonës së ofertimit sipas metodologjisë së përcaktuar në Nenin 21; dhe,

(c) të sigurojë që të gjitha grupet e pozicioneve neto të zonës së ofertimit dhe flukseve në linjat me rrymë të vazhduar që nuk e kalojnë kapacitetin ndër-zonal, të përputhen me margjinat e besueshmërisë dhe kufijtë e sigurisë së operimit në përputhje me Nenin 21(1)(a)(i) dhe (ii), të marrë parasysht kapacitetin ndër-zonal të alokuar më parë në përputhje me Nenin 21(1)(b)(iii).

4. Çdo llogaritës i kapacitetit të koordinuar do të optimizojë kapacitetin ndër-zonal duke përdorur veprimet e disponueshme përmirësuese të marra parasysh në llogaritjen e kapacitetit në përputhje me Nenin 21(1)(a)(iv).

5. Çdo llogaritës i kapacitetit të koordinuar do të zbatojë rregullat e ndarjes të përcaktuara në përputhje me Nenin 21(1)(b)(vi).

6 Çdo llogaritës i kapacitetit të koordinuar duhet të respektojë përshkrimin matematikor të metodës së aplikuar të llogaritjes së kapacitetit të përcaktuar në përputhje me Nenin 21(1)(b)(i).

7. Çdo llogaritës i kapacitetit të koordinuar që aplikon metodologjinë e bazuar në flukse fizike duhet:

(a) të përdorë të dhëna për kufijtë e sigurisë së operimit për të llogaritur flukset maksimale në elementët kritikë të rrjetit;

(b) të përdorë modelin e përbashkët të rrjetit, faktorët e zhvendosjes së gjenerimit dhe kontigjencat për të llogaritur faktorët e shpërndarjes së transferimit të energjisë;

(c) të përdorë faktorët e shpërndarjes së transferimit të energjisë për të llogaritur flukset që rezultojnë nga kapaciteti ndër-zonal i alokuar më parë në rajonin e llogaritjes së kapacitetit;

(d) të llogarisë flukset në elementet kritike të rrjetit për çdo skenar (duke marrë parasysh kontigjencat) dhe t'i përshtasë ato duke supozuar se nuk ka shkëmbime energjie ndër-zonale brenda rajonit të llogaritjes së kapacitetit, duke zbatuar rregullat për shmangien e diskriminimit të panevojshëm ndërmjet shkëmbimeve të brendshme dhe ndër-zonale në përputhje me Nenin 21(1)(b)(ii);

(e) të llogarisë margjinat e disponueshme në elementët kritikë të rrjetit, duke marrë parasysh kontigjencat, të cilat duhet të jenë të barabarta me flukset maksimale të reduktuara nga flukset e përshtatura të referuara në pikën (d), margjinat e besueshmërisë dhe flukset që rezultojnë nga kapaciteti ndër-zonal i alokuar më parë;

(f) të përshtasë margjinat e disponueshme në elementët kritikë të rrjetit ose faktorët e shpërndarjes së transferimit të energjisë duke përdorur veprimet përmirësuese të disponueshme që do të merren parasysh në llogaritjen e kapacitetit në përputhje me Nenin 25.

8. Çdo llogaritës i kapacitetit të koordinuar që zbaton metodologjinë e kapacitetit të koordinuar neto të transmetimit duhet:

(a) të përdorë modelin e përbashkët të rrjetit, faktorët e zhvendosjes së gjenerimit dhe kontigjencat për të llogaritur shkëmbimin maksimal të energjisë në kufijtë e zonës së ofertimit, i cili do të jetë i barabartë me shkëmbimin maksimal të llogaritur ndërmjet dy zonave të ofertimit në të dyja anët e kufirit të zonës së ofertimit duke respektuar kufijtë e sigurisë së operimit;

(b) të përshtasë shkëmbimin maksimal të energjisë duke përdorur veprimet përmirësuese të marra parasysh në llogaritjen e kapacitetit në përputhje me Nenin 25;

(c) të përshtasë shkëmbimin maksimal të energjisë, duke zbatuar rregullat për shmangien e diskriminimit të panevojshëm ndërmjet shkëmbimeve të brendshme dhe ndër-zonale në përputhje me Nenin 21(1)(b)(ii);

(d) të zbatojë rregullat e përcaktuara në përputhje me Nenin 21(1)(b)(vi) për të ndarë në mënyrë eficiente mundësitë e fluksit të energjisë të elementeve kritikë të rrjetit ndërmjet kufijve të ndryshëm të zonave të ofertimit;

(e) të llogarisë kapacitetin ndër-zonal, i cili do të jetë i barabartë me shkëmbimin maksimal të energjisë të korrigtuar me margjinën e besueshmërisë dhe kapacitetin ndër-zonal të alokuar më parë.

9. Çdo llogaritës i kapacitetit të koordinuar duhet të bashkëpunojë me llogaritësit fqinjë të kapacitetit të koordinuar. OST-të fqinje do të sigurojnë një bashkëpunim të tillë duke shkëmbyer dhe konfirmuar informacionin mbi ndërvarësinë me llogaritësit përkatës rajonalë të kapacitetit të koordinuar, për qëllime të llogaritjes dhe validimit të kapacitetit. OST-të fqinje do t'i japin informacion mbi ndërvarësinë llogaritësve të kapacitetit të koordinuar përpara llogaritjes së kapacitetit. Një vlerësim i saktësisë së këtij informacioni dhe masave korrigjuese do të përfshihen në raportin dyvjeçar të hartuar në përputhje me Nenin 31, sipas rastit.

10. Çdo llogaritës i kapacitetit të koordinuar do të përcaktojë:

(a) parametrat e bazuar në flukse fizike për çdo zonë ofertimi brenda rajonit të llogaritjes së kapacitetit, nëse zbatohet metodologjia e bazuar në flukse fizike; ose

(b) vlerat e kapacitetit ndër-zonal për çdo kufi të zonës së ofertimit brenda rajonit të llogaritjes së kapacitetit, nëse zbatohet metodologjia e kapacitetit të koordinuar neto të transmetimit.

11. Çdo llogaritës i kapacitetit të koordinuar do të dorëzojë kapacitetin ndër-zonal në çdo OST brenda rajonit të tij të llogaritjes së kapacitetit për validim në përputhje me Nenin 21(1)(c).

### **Neni 30**

#### **Validimi dhe shpërndarja e kapacitetit ndër-zonal**

1. Çdo OST do të validojë rezultatet e llogaritjes së kapacitetit rajonal për kufijtë e tij të zonës së ofertimit ose elementëve kritik të rrjetit, në përputhje me Nenin 26.

2. Çdo OST do të dërgojë validimin e kapacitetit dhe kufizimet e alokimit tek llogaritësit përkatës të kapacitetit të koordinuar dhe tek OST-të e tjera të rajoneve përkatëse të llogaritjes së kapacitetit.

3. Çdo llogaritës i kapacitetit të koordinuar do të sigurojë kapacitetet ndër-zonale të validuara dhe kufizimet e alokimit për qëllime të alokimit të kapacitetit në përputhje me Nenin 46 dhe 58.

### **Seksioni 5**

#### **Raporti dyvjeçar për llogaritjen dhe alokimin e kapacitetit**

### **Neni 31**

#### **Raporti dyvjeçar për llogaritjen dhe alokimin e kapacitetit**

1. Brenda tre viteve pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, ENTSO-E, duke vepruar në përputhje me Nenin 3 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC, do të përfshijë zonat e ofertimit të Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë në raportin mbi llogaritjen dhe alokimin e kapacitetit të hartuar në përputhje me Nenin 31(1) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222.

2. <...>

3. Për secilën zonë ofertimi, kufi të zonës së ofertimit dhe rajon të llogaritjes së kapacitetit, raporti për llogaritjen dhe alokimin e kapacitetit duhet të përmbajë të paktën:

(a) metodën e përdorur të llogaritjes së kapacitetit;

- (b) treguesit statistikorë mbi margjinat e besueshmërisë;
  - (c) treguesit statistikorë të kapacitetit ndër-zonal, duke përfshirë kufizimet e alokimit, aty ku është e përshtatshme, për çdo afat kohor të llogaritjes së kapacitetit;
  - (d) treguesit e cilësisë mbi informacionin e përdorur për llogaritjen e kapacitetit;
  - (e) aty ku është e përshtatshme, masat e propozuara për të përmirësuar llogaritjen e kapacitetit;
  - (f) për rajonet ku zbatohet metodologjia e kapacitetit të koordinuar neto të transmetimit, një analizë nëse kushtet e specifikuara në Nenin 20(7) janë ende në fuqi;
  - (g) treguesit për vlerësimin dhe ndjekjen afatgjatë të efikasitetit të bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, duke përfshirë bashkimin e rajoneve të llogaritjes së kapacitetit në përputhje me Nenin 15(3) aty ku është e përshtatshme;
  - (h) rekomandimet për zhvillimin e mëtejshëm të bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, përfshirë harmonizimin e metodologjive, proceseve dhe marrëveshjeve të qeverisjes.
4. Pas konsultimit me Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencinë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, të gjitha OST-të do të bien dakord së bashku për treguesit statistikor dhe cilësor të raportit. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë dhe Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë mund të kërkojnë ndryshimin e këtyre treguesve, para marrëveshjes ndërmjet OST-ve ose gjatë aplikimit të tyre.

5. <...>

## **KAPITULLI 2**

### **Konfigurimi i zonës së ofertimit**

#### **Neni 32**

#### **Rishikimi i konfigurimeve të zonave ekzistuese të ofertimit**

1. Një rishikim i një konfigurimi të zonave ekzistuese të ofertimit mund të fillojë nga:
- (a) Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, në përputhje me Nenin 34(7);
  - (b) disa autoritete rregullatore, në bazë të një rekomandimi nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë në përputhje me Nenin 34;
  - (c) OST-të e një rajoni të llogaritjes së kapacitetit, së bashku me të gjitha OST-të përkatëse, zonat e kontrollit të të cilave, përfshirë interkoneksionet, janë brenda zonës gjeografike në të cilën konfigurimi i zonës së ofertimit do të vlerësohet në përputhje me paragrafin 2(a);
  - (d) një autoritet i vetëm rregullator ose OST me miratimin e autoritetit kompetent rregullator të tij, për zonat e ofertimit brenda zonës së kontrollit të OST-së, nëse konfigurimi i zonës së ofertimit ka ndikim të papërfillshëm në zonat e kontrollit të OST-ve fqinje, përfshirë interkoneksionet, dhe rishikimi i konfigurimit të zonës së ofertimit është i nevojshëm për të përmirësuar efikasitetin ose për të ruajtur sigurinë e operimit;

(e) Shtetet Anëtare dhe Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë në një rajon të llogaritjes së kapacitetit.

2. Nëse një rishikim fillon në përputhje me paragrafin 1(a),(b), (c) ose (e), njësia që fillon rishikimin duhet të specifikojë:

(a) zonën gjeografike në të cilën do të vlerësohet konfigurimi i zonës së ofertimit dhe zonat gjeografike fqinje për të cilat do të merren parasysht ndikimet;

(b) OST-të pjesëmarrëse;

(c) autoritetet rregullatore pjesëmarrëse.

3. Nëse një rishikim fillon në përputhje me paragrafin 1(d), do të zbatohen kushtet e mëposhtme:

(a) zona gjeografike në të cilën vlerësohet konfigurimi i zonës së ofertimit do të kufizohet në zonën e kontrollit të OST-së përkatëse, përfshirë interkoneksionet;

(b) OST e zonës përkatëse të kontrollit do të jetë OST e vetme që merr pjesë në rishikim;

(c) autoriteti rregullator kompetent do të jetë i vetmi autoritet rregullator që merr pjesë në rishikim;

(d) OST-ja dhe autoriteti rregullator përkatës, respektivisht, do t'u japin OST-ve fqinje dhe autoriteteve rregullatore, njoftim paraprak, dakordësuar reciprokisht, për fillimin e rishikimit, duke dhënë arsyet; dhe

(e) kushtet për rishikimin do të specifikohen dhe rezultatet e rishikimit dhe propozimi për autoritetet rregullatore përkatëse do të publikohen.

4. Procesi i rishikimit përbëhet nga dy hapa.

(a) Në hapin e parë, OST-të pjesëmarrëse në një rishikim të konfigurimit të zonës së ofertimit do të hartojnë metodologjinë dhe supozimet që do të përdoren në procesin e rishikimit dhe do të propozojnë për vlerësim konfigurime alternative të zonës së ofertimit.

Propozimi për metodologjinë dhe supozimet dhe konfigurimin e zonës alternative të ofertimit do t'u dorëzohet autoriteteve rregullatore pjesëmarrëse, të cilat do të jenë në gjendje të kërkojnë ndryshime të koordinuara brenda tre muajve.

(b) Në hapin e dytë, OST-të pjesëmarrëse në një rishikim të konfigurimit të zonës së ofertimit duhet:

(i) të vlerësojnë dhe krahasojnë konfigurimin aktual të zonës së ofertimit dhe çdo konfigurim alternativ të zonës së ofertimit duke përdorur kriteret e specifikuar në Nenin 33;

(ii) të zhvillojnë një konsultim në përputhje me Nenin 12 dhe një workshop në lidhje me propozimet e konfigurimit të zonës alternative të ofertimit, krahasuar me konfigurimin ekzistues të zonës së ofertimit, përfshirë afatet kohore për zbatim, përveç rasteve ku konfigurimi i zonës së ofertimit ka ndikim të papërfillshëm në zonat e kontrollit të OST-ve fqinje;

(iii) ti paraqesë Palëve pjesëmarrëse Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe Shteteve Anëtare (për interkoneksionet e tyre me Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë) dhe autoriteteve rregullatore pjesëmarrëse, një propozim të përbashkët për të ruajtur ose ndryshuar konfigurimin e zonës së ofertimit, brenda 15 muajve nga vendimi për të nisur një rishikim.

(c) Me marrjen e propozimit të përbashkët për të ruajtur ose për të ndryshuar konfigurimin e zonës së ofertimit në përputhje me pikën (iii) më sipër, Shtetet pjesëmarrëse Anëtare dhe Palët pjesëmarrëse Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose, kur parashikohet nga Shtetet Anëtare dhe Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, autoritetet rregullatore, duhet brenda gjashtë muajve të arrijnë një marrëveshje mbi propozimin për të ruajtur ose ndryshuar konfigurimin e zonës së ofertimit.

5. NEMO-t ose pjesëmarrësit e tregut, nëse kërkohet nga OST-të, do t'u ofrojnë OST-ve pjesëmarrëse në një rishikim të një zone ofertimi informacion për t'u mundësuar atyre të vlerësojnë konfigurimet e zonës së ofertimit. Ky informacion do të ndahet vetëm ndërmjet OST-ve pjesëmarrëse me qëllimin e vetëm të vlerësimit të konfigurimeve të zonave të ofertimit.

6. Nisma për rishikimin e konfigurimit të zonave të ofertimit dhe rezultatet e saj do të publikohen nga ENTSO-E, duke vepruar në përputhje me Nenin 3 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC, ose nëse rishikimi është nisur në përputhje me paragrafin 1(d), nga OST pjesëmarrëse.

### **Neni 33**

#### **Kriteret e rishikimit të konfigurimeve të zonave të ofertimit**

1. Nëse një rishikim i konfigurimit të zonës së ofertimit kryhet në përputhje me Nenin 32, do të merren parasysh të paktën kriteret e mëposhtme:

(a) lidhur me sigurinë e rrjetit:

- (i) aftësia e konfigurimeve të zonave të ofertimit për të garantuar sigurinë e operimit dhe sigurinë e furnizimit;
- (ii) shkalla e pasigurisë në llogaritjen e kapacitetit ndër-zonal.

(b) lidhur me efikasitetin e përgjithshme të tregut:

- (i) çdo rritje ose ulje e efikasitetit ekonomike që rrjedh nga ndryshimi;
- (ii) efikasiteti i tregut, përfshirë të paktën koston e garantimit të pandryshueshmërisë së kapacitetit, likuiditetit të tregut, përqendrimit dhe fuqisë së tregut, mundësimin e konkurrencës efektive, sinjalet e çmimeve për ndërtimin e infrastrukturës, saktësinë dhe qëndrueshmërinë e sinjaleve të çmimeve;
- (iii) kostot e transaksionit dhe të tranzicionit, duke përfshirë koston e ndryshimit të detyrimeve ekzistuese kontraktuale të shkaktuara nga pjesëmarrësit e tregut, NEMO-t dhe OST-të;
- (iv) koston e ndërtimit të infrastrukturës së re e cila mund të lehtësojë kongestionin ekzistues;
- (v) nevojën për tu siguruar që rezultati i tregut është i realizueshëm pa nevojën e aplikimit të gjerë të veprimeve përmirësuese ekonomike joefikase;
- (vi) çdo efekt të padëshiruar të transaksioneve të brendshme në zonat e tjera të ofertimit për të siguruar përputhshmërinë me Nenin 16(9) të Rregullores (BE) 2019/943, siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Këshillit Ministror 2002/03/MC-EnC;
- (vii) impaktin në operimin dhe efikasitetin e mekanizmave balancues dhe proceset e shlyerjes së disbalancave.

(c) në lidhje me stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e zonave të ofertimit:

- (i) nevoja që zonat e ofertimit të jenë mjaftueshëm të qëndrueshme me kalimin e kohës;
- (ii) nevoja që zonat e ofertimit të jenë të qëndrueshme për të gjitha afatet kohore të llogaritjes së kapacitetit;
- (iii) nevoja që çdo njësi gjenerimi dhe ngarkese t'i përkasë vetëm një zone ofertimi për çdo njësi kohore të tregut;

(iv) vendndodhja dhe shpeshësia e kongjestionit, nëse kongjestioni strukturor ndikon në përcaktimin e zonave të ofertimit, duke marrë parasysh çdo investim të ardhshëm që mund të lehtësojë kongjestionin ekzistues.

2. Një rishikim i zonës së ofertimit në përputhje me Nenin 32 do të përfshijë skenarë që marrin parasysh një sërë zhvillimesh të mundshme të infrastrukturës përgjatë periudhës 10 vjeçare duke filluar nga viti pas vitit në të cilin është marrë vendimi për nisjen e rishikimit.

### **Neni 34**

#### **Raportimi i rregullt për konfigurimin aktual të zonës së ofertimit**

1. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, duke vepruar në përputhje me Nenin 2 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC do të vlerësojnë çdo tre vjet efiçencën e konfigurimit aktual të zonës së ofertimit.

Ata do:

(a) t'i kërkojnë ENTSO-E, duke vepruar në përputhje me Nenin 3 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC dhe Nenin 14 të Rregullores (BE) 2019/943, siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Këshillit Ministeror 2022/03/MC-EnC, të zgjerojë raportin teknik mbi konfigurimin aktual të zonës së ofertimit të hartuar në përputhje me Nenin 34(1)(a) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 për të përfshirë Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe

(b) të hartojnë një raport tregu që vlerëson ndikimin e konfigurimit aktual të zonës së ofertimit në efiçencën e tregut.

2. Raporti teknik i përmendur në paragrafin 1, nënparagrafi i dytë, pika (a), do të përfshijë të paktën:

(a) një listë të kongjestionit strukturor dhe kongjestionit tjetër fizik të rëndësishëm, duke përfshirë vendndodhjet dhe frekuencën;

(b) një analizë të zhvillimit të pritshëm ose eliminimit të kongjestionit fizik si rezultat i investimit në rrjete ose nga ndryshime të rëndësishme në modelet e gjenerimit ose konsumit;

(c) një analizë të pjesës së flukseve të energjisë që nuk rezultojnë nga mekanizmi i alokimit të kapacitetit, për çdo rajon të llogaritjes së kapacitetit, aty ku është e përshtatshme;

(d) të ardhurat nga kongjestioni dhe kostot e pandryshueshmërisë;

(e) një skenar që përfshin një afat kohor dhjetëvjeçar.

3. Çdo OST do të sigurojë të dhëna dhe analiza për të lejuar që raporti teknik mbi konfigurimin aktual të zonës së ofertimit të hartohet në kohën e duhur.

4. ENTSO-E do t'i dorëzojë Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, raportin teknik mbi konfigurimin aktual të zonës së ofertimit jo më vonë se nëntë muaj pas kërkesës nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë.

5. Aty ku është e mundur, raporti sipas kësaj Rregulloreje do të harmonizohet me raportin teknik të dorëzuar në përputhje me Nenin 34(3) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 dhe do të mbulojë tre vitet e fundit të plota kalendarike që i paraprijnë kërkesës nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë.

6. Pa çenuar detyrimet e konfidencialitetit të parashikuara në Nenin 13, ENTSO-E do të vërë në dispozicion të publikut raportin teknik.

7. Nëse raporti teknik ose i tregut zbulon mangësi në konfigurimin aktual të zonës së ofertimit, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, mund t'u kërkojë OST-ve të fillojnë një rishikim të konfigurimit ekzistues të zonës së ofertimit në përputhje me Nenin 32(1).

### **KAPITULLI 3**

#### **Ridispeçimi dhe Tregtimi me kah të kundërt**

##### **Neni 35**

#### **Ridispeçimi dhe tregtimi me kah të kundërt i koordinuar**

1. Brenda 16 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, të gjitha OST-të në çdo rajon të llogaritjes së kapacitetit do të hartojnë një propozim për një metodologji të përbashkët për ridispeçimin dhe tregtimin me kah të kundërt të koordinuar. Propozimi do t'i nënshtrohet konsultimit në përputhje me Nenin 12.

2. Metodologjia për ridispeçimin dhe tregtimin me kah të kundërt të koordinuar do të përfshijë veprime me rëndësi ndërkufitare dhe do t'u mundësojë të gjitha OST-ve në çdo rajon të llogaritjes së kapacitetit të lehtësojnë në mënyrë efektive kongestionin fizik, pavarësisht nëse arsyet e kongestionit fizik bien apo jo kryesisht jashtë zonës së tyre të kontrollit. Metodologjia për ridispeçimin dhe tregtimin me kah të kundërt të koordinuar do të trajtojë faktin se zbatimi i saj mund të ndikojë ndjeshëm në flukset jashtë zonës së kontrollit të OST-së.

3. Çdo OST mund të ridispeçojë të gjitha njësitë e disponueshme gjeneruese dhe të ngarkesës në përputhje me mekanizmat dhe marrëveshjet e përshtatshme të zbatueshme për zonën e tij të kontrollit, përfshirë interkoneksionet.

Brenda 26 muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të gjitha OST-të në çdo rajon të llogaritjes së kapacitetit do të hartojnë një raport, subjekt konsultimi në përputhje me Nenin 12, duke vlerësuar koordinimin dhe harmonizimin progresiv të këtyre mekanizmave dhe marrëveshjeve, përfshirë propozimet. Raporti do t'u dorëzohet autoriteteve të tyre rregullatore përkatëse për vlerësim. Propozimet në raport do të parandalojnë që këto mekanizma dhe marrëveshje të deformatojnë tregun.

4. Çdo OST duhet të evitojë masat e njëanshme ose të pakoordinuara të ridispeçimit dhe të tregimit me kah të kundërt me rëndësi ndërkufitare. Çdo OST do të koordinojë përdorimin e masave të ridispeçimit dhe të tregimit me kah të kundërt duke marrë parasysh ndikimin e tyre në sigurinë e operimit dhe efikasitetin ekonomik.

5. Njësitë përkatëse gjeneruese dhe të ngarkesës do t'u japin OST-ve çmimet e ridispeçimit dhe tregimit me kah të kundërt përpara se të angazhohen masat e ridispeçimit dhe tregimit me kah të kundërt.



Çmimi i ridispeçimit dhe tregtimit me kah të kundërt do të bazohet në:

(a) çmimet në tregjet përkatëse të energjisë elektrike për harkun kohor përkatës; ose

(b) koston e masave të ridispeçimit dhe të tregtimit me kah të kundërt llogaritur në mënyrë transparente mbi bazën e kostove të shkaktuara.

6. Njësitë e gjenerimit dhe të ngarkesës duhet të ofrojnë ex-ante të gjithë informacionin e nevojshëm për llogaritjen e koston së ridispeçimit dhe tregtimit me kah të kundërt tek OST-të përkatëse. Ky informacion do të ndahet ndërmjet OST-ve përkatëse vetëm për qëllime të ridispeçimit dhe tregtimit me kah të kundërt.

## **KAPITULLI 4**

### **Zhvillimi i algoritmit**

#### **Neni 36**

#### **Dispozita të përgjithshme**

1. Të gjitha NEMO-t duhet të zbatojnë:

(a) algoritmin e çmimit të tregut të bashkuar, dhe

(b) algoritmin e përputhjes së tregtimit të vazhdueshëm të hartuar në përputhje me Nenin 37 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222.

2. NEMO-t duhet të sigurohen që algoritmi i çmimit të tregut të bashkuar dhe algoritmi i përputhjes së tregtimit të vazhdueshëm të plotësojnë respektivisht kërkesat e parashikuara në Nenet 39 dhe 52.

3. Pas integritimit në bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë, NEMO-t në bashkëpunim me OST-të do të zbatojnë metodologjinë rezervë të përmendur në Nenin 9(6)(f).

4. Kur është e mundur, NEMO-t do të përdorin zgjidhje tashmë të miratuara për të zbatuar në mënyrë eficiente objektivat e kësaj Rregulloreje.

#### **Neni 37**

#### **Zhvillimi i algoritmit**

<...>

## **KAPITULLI 5**

### **Bashkimi i tregut të vetëm të ditës në avancë**

#### **Seksioni 1**

#### **Algoritmi i çmimit të tregut të bashkuar**

#### **Neni 38**

#### **Objektivat e algoritmit të çmimit të tregut të bashkuar**

1. Algoritmi i çmimit të tregut të bashkuar do të prodhojë rezultatet e përcaktuara në Nenin 39(2), në një mënyrë që:

(a) të synojë maksimizimin e tepricës ekonomike për bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë për rajonin me çmim të bashkuar për ditën pasardhëse të tregtimit;

(b) të përdorë parimin e çmimit marginal sipas të cilit të gjitha ofertat e pranuar do të kenë të njëjtin çmim për zonë ofertimi për njësi të kohës së tregut;

(c) lehtëson formimin efiçent të çmimeve;

(d) respekton kapacitetin ndër-zonal dhe kufizimet e alokimit;

(e) është i përsëritshëm dhe progresiv.

2. Algoritmi i çmimit të tregut të bashkuar do të zhvillohet në mënyrë të tillë që të jetë e mundur të zbatohet në një numër më të madh apo më të vogël të zonave të ofertimit.

### **Neni 39**

#### **Inputet dhe rezultatet e algoritmit të çmimit të tregut të bashkuar**

1. Për të prodhuar rezultate, algoritmi i çmimit të tregut të bashkuar do të përdorë:

(a) kufizimet e alokimit të përcaktuara në përputhje me Nenin 23(3);

(b) rezultatet e kapacitetit ndër-zonal të validuara në përputhje me Nenin 30;

(c) urdhërporositë e dorëzuara në përputhje me Nenin 40.

2. Algoritmi i çmimit të tregut të bashkuar duhet të prodhojë të paktën rezultatet e mëposhtme njëkohësisht për çdo afat kohor të tregut:

(a) një çmim të vetëm klerues për çdo zonë ofertimi dhe afat kohor të tregut në Euro/MWh;

(b) një pozicion të vetëm neto për çdo zonë ofertimi dhe çdo afat kohor të tregut;

(c) informacionin që mundëson përcaktimin e statusit të ekzekutimit të urdhërporosive.

3. Të gjitha NEMO-t duhet të sigurojnë saktësinë dhe efiçencën e rezultateve të prodhuara nga algoritmi i çmimit të tregut të vetëm të bashkuar.

4. Të gjitha OST-të duhet të verifikojnë që rezultatet e algoritmit të çmimit të tregut të bashkuar janë në përputhje me kapacitetin ndër-zonal dhe kufizimet e alokimit.

### **Neni 40**

#### **Produktet e akomoduar**

1. NEMO-t duhet të sigurohen që urdhërporositë që rezultojnë nga produktet e disponueshme për algoritmin e çmimit të tregut të bashkuar të shprehen në Euro dhe t'i referohen afatit të tregut.

2. Të gjithë NEMO-t duhet të sigurohen që algoritmi i çmimit të tregut të bashkuar të jetë në gjendje të akomodojë urdhërporositë që rezultojnë nga këto produkte duke mbuluar një afat kohor të tregut dhe njësi të shumta kohore të tregut.

3. Brenda dy vitesh pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje dhe në çdo të dytin vit pasardhës, të gjithë NEMO-t do të konsultohen në përputhje me Nenin 12:

(a) me pjesëmarrësit e tregut, për të siguruar që produktet e disponueshme pasqyrojnë nevojat e tyre;

(b) të gjithë OST-të, për të siguruar që produktet të marrin në konsideratë sigurinë e operimit;

(c) të gjitha autoritetet rregullatore, për të siguruar që produktet e disponueshme janë në përputhje me objektivat e kësaj Rregulloreje.

4. Të gjithë NEMO-t do të ndryshojnë produktet nëse është e nevojshme në përputhje me rezultatet e konsultimit të përmendur në paragrafin 3.

#### **Neni 41**

##### **Çmimet maksimale dhe minimale**

1. Pas integritit në bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë, NEMO-t, në bashkëpunim me OST-të përkatëse, do të aplikojnë çmimet maksimale dhe minimale të përmendura në Nenin 9(6)(i).

2. <...>

#### **Neni 42**

##### **Çmimi i kapacitetit ndër-zonal të tregut të ditës në avancë**

1. Tarifa e kapacitetit ndër-zonal e tregut të ditës në avancë do të pasqyrojë kongestionin e tregut dhe do të jetë e barabartë me diferencën ndërmjet çmimeve kleruese korresponduese të ditës në avancë të zonave përkatëse të ofertimit.

2. Asnjë tarifë, si tarifa e disbalancave ose tarifa shtesë, nuk do të aplikohet për kapacitetin ndër-zonal të ditës në avancë, përveç çmimit të përcaktuar në përputhje me paragrafin 1.

#### **Neni 43**

##### **Metodologjia për llogaritjen e shkëmbimeve të skeduluara që rezultojnë nga bashkimi i tregut të vetëm të ditës në avancë**

1. Brenda 16 muajve pas tejkalimit të afatit për transpozim, OST-të të cilat synojnë të llogarisin shkëmbimet e skeduluara që rezultojnë nga bashkimi i tregut të vetëm të ditës në avancë do të hartojnë një propozim për një metodologji të përbashkët për këtë llogaritje. Propozimi do t'i nënshtrohet konsultimit në përputhje me Nenin 12.

2. Metodologjia do të përshkruajë llogaritjen dhe do të listojë informacionin që do t'i jepet nga NEMO-t përkatëse llogaritësit të shkëmbimeve të skeduluara të krijuar në përputhje me Nenin 8(2)(g) dhe afatet kohore për dhënien e këtij informacioni. Afati kohor për dhënien e informacionit do të jetë jo më vonë se ora 15:30 e tregut të ditës në avancë.

3. Llogaritja do të bazohet në pozicionet neto për çdo njësi kohore të tregut.

4. Jo më vonë se dy vjet pas miratimit të propozimit të përmendur në paragrafin 1 nga autoritetet rregullatore të rajonit përkatës, OST-të që aplikojnë shkëmbime të skeduluara do të rishikojnë metodologjinë. Në vazhdimësi, nëse kërkohet nga autoritetet rregullatore kompetente, metodologjia do të rishikohet çdo dy vjet.

## **Neni 44**

### **Përcaktimi i procedurave alternative**

Brenda 16 muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, çdo OST, në koordinim me të gjitha OST-të e tjera në rajonin e llogaritjes të kapacitetit, do të hartojë një propozim për procedura alternative të sigurta dhe në kohë për të siguruar alokim eficient, transparent dhe mosdiskriminues të kapacitetit në rast se bashkimi i tregut të vetëm të ditës në avancë nuk është në gjendje të prodhojë rezultate.

Propozimi për përcaktimin e procedurave alternative do të përafrohet me procedurën e përcaktuar sipas nenit 44 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 dhe do t'i nënshtrohet konsultimit në përputhje me Nenin 12.

## **Neni 45**

### **Marrëveshje lidhur me më shumë se një NEMO në një zonë ofertimi dhe për interkoneksionet që nuk operohen nga OST të çertifikuara**

1. OST-të në zonat e ofertimit ku është emërtuar dhe/ose ofron shërbime tregtare më shumë se një NEMO, ose ku ka interkoneksione të cilat nuk operohen nga OST të çertifikuara sipas nenit 51 të Rregullores (BE) Nr. 2019/943 siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC, do të hartojnë një propozim për alokimin e kapacitetit ndër-zonal dhe marrëveshjeve të tjera të nevojshme për zona të tilla të ofertimit në bashkëpunim me OST-të përkatëse, NEMO-t dhe operatorët e interkoneksioneve që nuk janë të çertifikuar si OST për të siguruar që NEMO-t dhe interkoneksionet përkatëse ofrojnë të dhënat e nevojshme dhe mbulimin financiar për këto marrëveshje. Këto marrëveshje duhet të lejojnë OST dhe NEMO të tjera të bëhen pjesë në këto marrëveshje.

2. Propozimi do t'i dorëzohet autoriteteve rregullatore kombëtare përkatëse për miratim brenda dymbëdhjetë muajve pasi më shumë se një NEMO është emërtuar dhe/ose lejuar të ofrojë shërbime tregtare në një zonë ofertimi ose nëse një interkoneksion i ri nuk operohet nga një OST i çertifikuar. Për interkoneksionet ekzistuese të cilat nuk operohen nga OST të çertifikuara, propozimi do të dorëzohet brenda dymbëdhjetë muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

## **Seksioni 2**

### **Procesi i bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë**

## **Neni 46**

### **Sigurimi i të dhënave hyrëse**

1. Çdo llogaritës i kapacitetit të koordinuar duhet të sigurojë që kapaciteti ndër-zonal dhe kufizimet e alokimit do t'u ofrohen NEMO-ve përkatës në kohë për të siguruar publikimin e kapacitetit ndër-zonal dhe të kufizimeve të alokimit në treg jo më vonë se ora 11:00 e tregut të ditës në avancë.

2. Nëse një llogaritës i kapacitetit të koordinuar nuk është në gjendje të sigurojë kapacitetin ndër-zonal dhe kufizimet e alokimit një orë përpara kohës së mbylljes së portës së tregut të ditës në avancë, ai llogaritës i kapacitetit të koordinuar duhet të njoftojë NEMO-t përkatës. Këto NEMO duhet të publikojnë menjëherë një njoftim për pjesëmarrësit e tregut.

Në raste të tilla, kapaciteti ndër-zonal dhe kufizimet e alokimit do të sigurohen nga llogaritësi i kapacitetit të koordinuar jo më vonë se 30 minuta përpara kohës së mbylljes së portës së tregut të ditës në avancë.

## **Neni 47**

### **Funksionimi i bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë**

1. Orari i hapjes së portës të tregut të ditës në avancë do të jetë jo më vonë se ora 11:00 e tregut të ditës në avancë.
2. Orari i mbylljes së portës së tregut të ditës në avancë në secilën zonë ofertimi do të jetë ora e mesditës së tregut të ditës në avancë. OST-të ose NEMO-t mund të caktojnë një orar të ndryshëm të mbylljes së portës përpara se të bëhen pjesë e bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë.
3. Pjesëmarrësit e tregut do t'i dorëzojnë të gjitha urdhërporositë tek NEMO-t përkatës përpara kohës së mbylljes së portës së tregut të ditës në avancë, në përputhje me Nenin 39 dhe 40.
4. Çdo NEMO do të dorëzojë urdhërporositë e marra në përputhje me paragrafin 3 për të kryer funksionet e OBT në përputhje me Nenin 7(2) në harmoni me algoritmin e çmimit të tregut të bashkuar të aplikuar në përputhje me Nenin 36.
5. Urdhërporositë e përputhura në bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë do të konsiderohen të pandryshueshme.
6. Funksionet e OBT duhet të sigurojnë anonimitetin e urdhërporosive të dorëzuara.

## **Neni 48**

### **Dorëzimi i rezultateve**

1. Të gjithë NEMO-t që kryejnë funksione OBT duhet ti japin rezultatet e bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë:
  - (a) të gjitha OST-ve, të gjithë llogaritësve të kapacitetit të koordinuar dhe të gjithë NEMO-ve, për rezultatet e specifikuar në Nenin 39(2)(a) dhe (b);
  - (b) të gjithë NEMO-ve, për rezultatet e specifikuar në Nenin 39(2)(c).
2. Çdo OST do të verifikojë që rezultatet e bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë të algoritmit të çmimit të tregut të bashkuar të përmendur në Nenin 39(2)(b) janë llogaritur në përputhje me kufizimet e alokimit dhe kapacitetin e validuar ndër-zonal.
3. Çdo NEMO do të verifikojë që rezultatet e bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë të algoritmit të çmimit të tregut të bashkuar të përmendur në Nenin 39(2)(c) janë llogaritur në përputhje me urdhërporositë.
4. Çdo NEMO do të informojë pjesëmarrësit e tregut mbi statusin e ekzekutimit të urdhërporosive të tyre pa vonesa të pajustificueshme.

## **Neni 49**

### **Llogaritja e shkëmbimeve të skeduluara që rezultojnë nga bashkimi i tregut të vetëm të ditës në avancë**

1. Çdo llogaritës i shkëmbimeve të skeduluara do të llogarisë shkëmbimet e skeduluara ndërmjet zonave të ofertimit për çdo afat kohor të tregut në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në Nenin 43.

2. Çdo llogaritës i shkëmbimeve të skeduluara do të njoftojë NEMO-t përkatës, kundërpalët qendrore, agjentët e transferimit dhe OST-të për shkëmbimet e skeduluara të dakordësuara.

## **Neni 50**

### **Fillimi i procedurave alternative**

1. Në rast se të gjithë NEMO-t që kryejnë funksione OBT nuk janë në gjendje të japin një pjesë ose të gjitha rezultatet e algoritmit të çmimit të tregut të bashkuar, aplikuar në përputhje me Nenin 36, do të zbatohen procedurat alternative të përcaktuara në përputhje me Nenin 44.

2. Në rastet kur ekziston një rrezik që të gjithë NEMO-t që kryejnë funksionet e OBT nuk janë në gjendje të japin një pjesë ose të gjitha rezultatet brenda afatit, të gjithë NEMO-t duhet të njoftojnë të gjithë OST-të sapo të identifikohet rreziku. Të gjithë NEMO-t që kryejnë funksione OBT duhet të publikojnë menjëherë një njoftim për pjesëmarrësit e tregut se procedurat alternative mund të zbatohen.

## **KAPITULLI 6**

### **Bashkimi i tregut të vetëm brenda së njëjtës ditë**

#### **Seksioni 1**

#### **Objektivat, kushtet dhe rezultatet e bashkimit të tregut të vetëm brenda së njëjtës ditë**

#### **Neni 51**

#### **Objektivat e algoritmit të përputhjes së tregtimit të vazhdueshëm**

1. Nga koha e hapjes së portës ndër-zonale të tregut brenda së njëjtës ditë deri në kohën e mbylljes së portës ndër-zonale të tregut brenda së njëjtës ditë, algoritmi i përputhjes së tregtimit të vazhdueshëm do të përcaktojë se cilat urdhërporosi duhet të zgjidhen për përputhje, në mënyrë që përputhja:

(a) të synojë maksimizimin e tepicës ekonomike për bashkimin e tregut të vetëm brenda së njëjtës ditë për transaksion për afatin kohor të tregut brenda së njëjtës ditë duke i alokuar kapacitet urdhërporosive për të cilat është e mundur përputhja me çmimin dhe kohën e dorëzimit;

(b) të respektojë kufizimet e alokimit përcaktuar në përputhje me Nenin 58(1);

(c) të respektojë kapacitetin ndër-zonal përcaktuar në përputhje me Nenin 58(1);

(d) të respektojë kërkesat për dorëzimin e rezultateve përcaktuar në Nenin 60;

(e) të jetë i përsëritshëm dhe i përshkallëzuar.

2. Algoritmi i përputhjes së tregtimit të vazhdueshëm duhet të prodhojë rezultatet e parashikuara në Nenin 52 dhe të korrespondojë me aftësitë dhe funksionalitetet e produktit përcaktuar në Nenin 53.

#### **Neni 52**

#### **Rezultatet e algoritmit të përputhjes së tregtimit të vazhdueshëm**

1. Të gjithë NEMO-t, si pjesë e funksionit të tyre si OBT, duhet të sigurohen që algoritmi i përputhjes së tregtimit të vazhdueshëm të prodhojë të paktën rezultatet e mëposhtme:

(a) statusin e ekzekutimit të urdhërporosive dhe çmimeve për transaksion;

(b) një pozicion të vetëm neto për çdo zonë ofertimi dhe njësi të afatit kohor brenda tregut të së njëjtës ditë.

2. Të gjithë NEMO-t duhet të sigurojnë saktësinë dhe efikasitetin e rezultateve të prodhuara nga algoritmi i përputhjes së tregtimit të vazhdueshëm.

3. Të gjitha OST-të do të verifikojnë që rezultatet e algoritmit të përputhjes së tregtimit të vazhdueshëm janë në përputhje me kapacitetin ndër-zonal dhe kufizimet e alokimit në përputhje me Nenin 58(2).

### **Neni 53**

#### **Produktet e akomoduar**

1. NEMO-t do të sigurohen që të gjitha urdhërporositë që rezultojnë nga produktet e disponueshme për funksionet e OBT do të kryhen në përputhje me Nenin 7, do të shprehen në Euro dhe do t'i referohen afatit të tregut dhe njësisë kohore të tregut.

2. Të gjithë NEMO-t duhet të sigurohen që urdhërporositë që rezultojnë nga këto produkte të jenë në përputhje me karakteristikat e kapacitetit ndër-zonal, duke i lejuar ato të përputhen në të njëjtën kohë.

3. Të gjithë NEMO-t duhet të sigurohen që algoritmi i përputhjes së tregtimit të vazhdueshëm të jetë në gjendje të akomodojë urdhërporositë që mbulojnë një ose disa njësi kohore tregu.

4. Brenda dy vitesh pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje dhe në çdo të dytin vit pasardhës, të gjithë NEMO-t do të konsultohen në përputhje me Nenin 12:

(a) me pjesëmarrësit e tregut, për të siguruar që produktet e disponueshme pasqyrojnë nevojat e tyre;

(b) të gjithë OST-të, për të siguruar që produktet të kenë parasysh sigurinë e operimit;

(c) të gjitha autoritetet rregullatore, për të siguruar që produktet e disponueshme janë në përputhje me objektivat e kësaj Rregulloreje.

5. Të gjithë NEMO-t do të ndryshojnë produktet nëse është e nevojshme në përputhje me rezultatet e konsultimit të përmendur në paragrafin 4.

### **Neni 54**

#### **Çmimet maksimale dhe minimale**

1. NEMO-t, në bashkëpunim me OST-të përkatëse, do të zbatojnë çmimet maksimale dhe minimale të përmendura në Nenin 9(6)(i).

2. <...>

3. <...>

### **Neni 55**

#### **Çmimi i kapacitetit brenda së njëjtës ditë**

1. <...>

2. <...>

3. Të gjitha OST-të do të zbatojnë metodologjinë e vetme për çmimin e kapacitetit ndër-zonal brenda së njëjtës ditë të përmendur në Nenin 9(6)(j).

4. Asnjë tarifë, si tarifa e disbalancave ose tarifa shtesë, nuk do të aplikohet për kapacitetin ndër-zonal brenda së njëjtës ditë, përveç çmimit të përcaktuar në përputhje me Nenin 55(1, 2 dhe 3) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222.

## **Neni 56**

### **Metodologjia për llogaritjen e shkëmbimeve të skeduluara që rezultojnë nga bashkimi i tregut të vetëm brenda së njëjtës ditë**

1. Brenda 16 muajve pas integrimit në bashkimin e tregut të vetëm brenda së njëjtës ditë, OST-të që synojnë të llogarisin shkëmbimet e skeduluara që rezultojnë nga bashkimi i tregut të vetëm brenda së njëjtës ditë do të hartojnë një propozim për një metodologji të përbashkët për këtë llogaritje.

Propozimi do t'i nënshtrohet konsultimit në përputhje me Nenin 12.

2. Metodologjia do të përshkruajë llogaritjen dhe, kur kërkohet, do të listojë informacionin që NEMO-t përkatës do t'i japin llogaritësit të shkëmbimeve të skeduluara dhe afatet kohore për dhënien e këtij informacioni.

3. Llogaritja e shkëmbimeve të skeduluara do të bazohet në pozicionet neto siç specifikohet në Nenin 52(1)(b).

4. Jo më vonë se dy vjet pas miratimit nga autoritetet rregullatore të rajonit përkatës të propozimit të përmendur në paragrafin 1, OST-të përkatëse do të rishikojnë metodologjinë. Më pas, nëse kërkohet nga autoritetet rregullatore kompetente, OST-të do të rishikojnë metodologjinë çdo dy vjet.

## **Neni 57**

### **Marrëveshje lidhur me më shumë se një NEMO në një zonë ofertimi dhe për interkoneksionet që nuk operohen nga OST të çertifikuara**

1. OST-të në zonat e ofertimit ku më shumë se një NEMO është emërtuar dhe/ose ofron shërbime tregtare, ose ku ka interkoneksione të cilat nuk operohen nga OST të çertifikuara sipas nenit 51 të Rregullores (BE) Nr. 2019/943 siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Këshillit Ministeror 2022/03/MC-EnC, do të hartojnë një propozim për alokimin e kapacitetit ndër-zonal dhe marrëveshjeve të tjera të nevojshme për këto zona ofertimi në bashkëpunim me OST-të përkatëse, NEMO-t dhe operatorët e interkoneksioneve që nuk janë të çertifikuar si OST për të siguruar që NEMO-t dhe interkoneksionet ofrojnë të dhënat e nevojshme dhe mbulim financiar për këto marrëveshje. Këto marrëveshje duhet të lejojnë OST dhe NEMO të tjera t'u bashkohen këtyre marrëveshjeve.

2. Propozimi do të dorëzohet për miratim nga autoritetet përkatëse rregullatore kombëtare brenda dymbëdhjetë muajve pasi më shumë se një NEMO është emërtuar dhe/ose lejuar të ofrojë shërbime tregtare në një zonë ofertimi ose nëse një interkoneksion i ri nuk operohet nga një OST e çertifikuar. Për interkoneksionet ekzistuese të cilat nuk operohen nga OST të çertifikuara, propozimi do të dorëzohet brenda dymbëdhjetë muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.



## **Seksioni 2**

### **Procesi i bashkimit të tregut të vetëm brenda së njëjtës ditë**

#### **Neni 58**

##### **Sigurimi i të dhënave hyrëse**

1. Çdo llogaritës i kapacitetit të koordinuar duhet të sigurohet që kapaciteti ndër-zonal dhe kufizimet e alokimit t'u ofrohen NEMO-ve përkatës jo më vonë se 15 minuta përpara kohës së hapjes së portës ndër-zonale të tregut brenda së njëjtës ditë.
2. Nëse nevojiten përditësime të kapacitetit ndër-zonal dhe kufizimeve të alokimit për shkak të ndryshimeve operacionale në sistemin e transmetimit, çdo OST do të njoftojë llogaritësit e kapacitetit të koordinuar në rajonin e tij të llogaritjes së kapacitetit. Llogaritësit e kapacitetit të koordinuar do të njoftojnë më pas NEMO-t përkatës.
3. Nëse ndonjë llogaritës i kapacitetit të koordinuar nuk është në gjendje të përmbushë kërkesat e paragrafit 1, ai llogaritës i kapacitetit të koordinuar do të njoftojë NEMO-t përkatës. Këto NEMO do të publikojnë një njoftim për të gjithë pjesëmarrësit e tregut pa vonesa të pajustificueshme.

#### **Neni 59**

##### **Funksionimi i bashkimit të tregut të vetëm brenda së njëjtës ditë**

1. OST-të do të zbatojnë kohën e hapjes së portës ndër-zonale të tregut brenda së njëjtës ditë dhe kohën e mbylljes së portës ndër-zonale të tregut brenda së njëjtës ditë të përmendura në Nenin 9(6)(k).
2. Koha e mbylljes së portës ndër-zonale të tregut brenda së njëjtës ditë do të caktohet në atë mënyrë që:
  - (a) maksimizon mundësitë e pjesëmarrësve të tregut për të rregulluar balancën e tyre duke tregtuar në periudhën kohore të tregut brenda së njëjtës ditë sa më afër kohës reale; dhe
  - (b) u siguron OST-ve dhe pjesëmarrësve të tregut kohë të mjaftueshme për proceset e tyre të skedulimit dhe balancimit në lidhje me sigurinë e operimit të rrjetit.
3. Për çdo kufi të caktuar të zonës së ofertimit do të përcaktohet një kohë e mbylljes së portës ndër-zonale brenda së njëjtës ditë për çdo njësi kohore të tregut. Kjo kohë do të jetë maksimumi një orë përpara fillimit të njësive përkatëse të kohës së tregut dhe do të marrë parasysh proceset përkatëse të balancimit në lidhje me sigurinë e operimit.
4. Tregtimi i energjisë në tregun brenda së njëjtës ditë për një njësi të caktuar kohore të tregut për një kufi të zonës së ofertimit do të fillojë jo më vonë se në kohën e hapjes së portës ndër-zonale brenda së njëjtës ditë të kufijve përkatës të zonës së ofertimit dhe do të lejohet deri në kohën e mbylljes së portës ndër-zonale brenda së njëjtës ditë.
5. Përpara kohës së mbylljes së portës ndër-zonale brenda së njëjtës ditë, pjesëmarrësit e tregut duhet t'u dorëzojnë NEMO-ve përkatës të gjitha urdhërporositë për një njësi të caktuar kohore të tregut. Të gjithë NEMO-t do të dorëzojnë urdhërporositë për një njësi të caktuar kohore të tregut për përputhje të vetme menjëherë pasi të jenë marrë urdhërporositë nga pjesëmarrësit e tregut.
6. Urdhërporositë e përputhura në bashkimin e tregut të vetëm brenda së njëjtës ditë do të konsiderohen të pandryshueshme.

7. Funkcionet e OBT do të sigurojnë anonimitetin e urdhërporosive të dorëzuara përmes librit të përbashkët të ofertave.

## **Neni 60**

### **Dorëzimi i rezultateve**

1. Të gjithë NEMO-t që kryejnë funksione OBT duhet të japin rezultatet e algoritmit të përputhjes së tregtimit të vazhdueshëm:

(a) tek të gjithë NEMO-t e tjerë, për rezultatet mbi statusin e ekzekutimit për transaksion të specifikuar në Nenin 52(1)(a);

(b) tek të gjithë OST-të dhe llogaritësit e shkëmbimeve të skeduluara, për rezultatet e pozicioneve të vetme neto të specifikuara në Nenin 52(1)(b).

2. Nëse, në përputhje me paragrafin 1(a), çdo NEMO, për arsye jashtë përgjegjësisë së tij, nuk është në gjendje të japë këto rezultate të algoritmit të përputhjes së tregtimit të vazhdueshëm, ai duhet të njoftojë të gjithë NEMO-t e tjerë.

3. Nëse, në përputhje me paragrafin 1(b), çdo NEMO, për arsye jashtë përgjegjësisë së tij, nuk është në gjendje të japë këto rezultate të algoritmit të përputhjes së tregtimit të vazhdueshëm, ai duhet të njoftojë të gjitha OST-të dhe çdo llogaritës të shkëmbimeve të skeduluara, sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur. Të gjithë NEMO-t duhet të njoftojnë pjesëmarrësit përkatës të tregut.

4. Të gjithë NEMO-t do t'u dërgojnë, pa vonesa të panevojshme, informacionin e nevojshëm pjesëmarrësve të tregut për të siguruar që veprimet e specifikuara në Nenet 68 dhe 73(3) të mund të ndërmerren.

## **Neni 61**

### **Llogaritja e shkëmbimeve të skeduluara që rezultojnë nga bashkimi i tregut të vetëm brenda së njëjtës ditë**

1. Çdo llogaritës i shkëmbimeve të skeduluara do të llogarisë shkëmbimet e skeduluara ndërmjet zonave të ofertimit për çdo njësi kohore të tregut bazuar në metodologjinë e përcaktuar në përputhje me Nenin 56.

2. Çdo llogaritës i shkëmbimeve të skeduluara do të njoftojë NEMO-t përkatës, kundërpalët qëndrore, agjentët e transferimit dhe OST-të e shkëmbimeve të skeduluara të dakordësuara.

## **Neni 62**

### **Publikimi i informacionit mbi tregun**

1. Sapo urdhërporositë të përputhen, çdo NEMO do të publikojë për pjesëmarrësit përkatës të tregut të paktën statusin e ekzekutimit të urdhërporosive dhe çmimet për transaksion të prodhuara nga algoritmi i përputhjes së tregtimit të vazhdueshëm bazuar në Nenin 52(1)(a).

2. Çdo NEMO do të sigurohet që informacioni mbi vëllimet e grupuara të ekzekutuara dhe çmimet të bëhet publikisht i disponueshëm në një format lehtësisht të aksesueshëm për të paktën 5 vjet.

## **Neni 63**

### **Ankandet rajonale plotësuese**

1. NEMO-t dhe OST-të përkatëse në kufijtë e zonave të ofertimit mund të paraqesin së bashku një propozim të përbashkët për hartimin dhe zhvillimin e ankandeve rajonale plotësuese brenda së njëjtës ditë. Propozimi duhet të jetë në harmoni me propozimet e paraqitura në përputhje me Nenin 63(1) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 mbi ankandet rajonale plotësuese brenda së njëjtës ditë dhe Nenin 55(1) mbi çmimin e kapacitetit brenda së njëjtës ditë.

Propozimi do t'i nënshtrohet konsultimit në përputhje me Nenin 12.

2. Ankandet rajonale plotësuese brenda së njëjtës ditë mund të zbatohen brenda ose ndërmjet zonave të ofertimit, përveç zgjidhjes së bashkimit të tregut të vetëm brenda së njëjtës ditë të përmendur në Nenin 51. Për të zhvilluar ankande rajonale brenda së njëjtës ditë, tregtimi i vazhdueshëm brenda dhe ndërmjet zonave përkatëse të ofertimit mund të ndërpritet për një periudhë të kufizuar kohore përpara kohës së mbylljes së portës ndër-zonale brenda së njëjtës ditë, e cila nuk duhet të tejkalojë kohën minimale të nevojshme për zhvillimin e ankandit dhe në çdo rast 10 minuta.

3. Për ankandet rajonale plotësuese brenda së njëjtës ditë, metodologjia për përcaktimin e çmimit të kapacitetit ndër-zonal brenda së njëjtës ditë mund të ndryshojë nga metodologjia e përcaktuar në përputhje me Nenin 55(3), por megjithatë duhet të përmbushë parimet e parashikuara në Nenin 55(1) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222.

4. Autoritetet rregullatore kompetente mund të miratojnë propozimin për ankande rajonale plotësuese brenda së njëjtës ditë nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

(a) ankandet rajonale nuk do të kenë një ndikim negativ në likuiditetin e bashkimit të tregut të vetëm brenda së njëjtës ditë;

(b) i gjithë kapaciteti ndër-zonal do të alokohet përmes modulit të menaxhimit të kapacitetit;

(c) ankandi rajonal nuk do të paraqesë ndonjë diskriminim të padrejtë ndërmjet pjesëmarrësve të tregut nga rajonet kufitare;

(d) oraret e ankandeve rajonale do të jenë në përputhje me bashkimin e tregut të vetëm brenda së njëjtës ditë për t'u mundësuar pjesëmarrësve të tregut të tregtojnë sa më afër të jetë e mundur me kohën reale;

(e) autoritetet rregullatore duhet të jenë konsultuar me pjesëmarrësit e tregut në Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe Shtetet përkatëse Anëtare.

5. Të paktën çdo dy vjet pas vendimit për ankandet rajonale plotësuese, autoritetet e interesuara rregullatore të Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe Shteteve Anëtare do të rishikojnë përputhshmërinë e çdo zgjidhjeje rajonale me bashkimin e tregut të vetëm brenda së njëjtës ditë për tu siguruar që kushtet e mësipërme vazhdojnë të përmbushen.

### **Seksioni 3**

#### **Marrëveshje kalimtare të tregut brenda së njëjtës ditë**

##### **Neni 64**

##### **Dispozita lidhur me alokimin eksplicit**

<...>

##### **Neni 65**

##### **Heqja e alokimit eksplicit**

<...>

##### **Neni 66**

#### **Dispozita lidhur me marrëveshjet e tregut brenda së njëjtës ditë**

<...>

##### **Neni 67**

##### **Kërkesa eksplicite për kapacitet**

<...>

### **KAPITULLI 7**

#### **Klerimi dhe shlyerja për bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë**

##### **Neni 68**

##### **Klerimi dhe shlyerja**

1. Kundërpalët qendrore kontraktuale duhet të sigurojnë në kohën e duhur klerimin dhe shlyerjen e të gjitha urdhërporosive të përputhura. Kundërpalët qendrore do të veprojnë si palë homologe ndaj pjesëmarrësve të tregut për të gjitha transaksionet e tyre në lidhje me të drejtat dhe detyrimet financiare që rrjedhin nga këto transaksione.

2. Çdo kundërpalë qendrore ruan anonimitetin ndërmjet pjesëmarrësve në treg.

3. Kundërpalët qendrore do të veprojnë si palë homologe mes tyre, për shkëmbimin e energjisë ndërmjet zonave të ofertimit në lidhje me të drejtat dhe detyrimet financiare që rrjedhin nga këto shkëmbime energjetike.

4. Këto shkëmbime do të marrin parasysh:

(a) pozicionet neto të prodhuara në përputhje me Nenet 39(2)(b) dhe 52(1)(b);

(b) shkëmbimet e skeduluara të llogaritura në përputhje me Nenet 49 dhe 61.

5. Çdo kundërpalë qendrore do të sigurojë që për çdo njësi kohore të tregut:

(a) në të gjitha zonat e ofertimit, duke marrë parasysh, aty ku është e përshtatshme, kufizimet e alokimit, nuk ka devijime ndërmjet shumës së energjisë së transferuar nga të gjitha zonat e ofertimit me teprica dhe shumës së energjisë së transferuar në të gjitha zonat e ofertimit me mungesa;

(b) eksportet e energjisë elektrike dhe importet e energjisë elektrike ndërmjet zonave të ofertimit janë të barabarta, ku devijimet rezultojnë vetëm nga marrja në konsideratë e kufizimeve të alokimit, aty ku është e përshtatshme.

6. Pavarësisht nga paragrafi 3, një agjent transferimi mund të veprojë si palë homologe ndërmjet kundërpalëve të ndryshme qendrore për shkëmbimin e energjisë, nëse palët e interesuara lidhin një marrëveshje specifike për këtë qëllim. Nëse nuk arrihet marrëveshje, marrëveshja e transferimit do të vendoset nga autoritetet rregullatore përgjegjëse për zonat e ofertimit ndërmjet të cilave kërkohet klerimi dhe shlyerja e shkëmbimit të energjisë.

7. Të gjitha kundërpalët qendrore ose agjentët e transferimit do të mbledhin të ardhurat nga kongjestioni që rrjedhin nga bashkimi i tregut të vetëm të ditës në avancë, i specifikuar në Nenet 46 deri në 48 dhe nga bashkimi i tregut të vetëm brenda së njëjtës ditë, i specifikuar në Nenet 58 deri në 60.

8. Të gjitha kundërpalët qendrore ose agjentët e transferimit do të sigurohen që të ardhurat e mbledhura nga kongjestioni t'i transferohen OST-ve jo më vonë se dy javë pas datës së shlyerjes.

9. Nëse afati i pagesave nuk është harmonizuar ndërmjet dy zonave të ofertimit, Palët përkatëse Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe Shtetet Anëtare do të sigurohen që një njësi të caktohet për të menaxhuar mospërputhjen e afatit dhe përbalimin e kostove përkatëse.

## **KAPITULLI 8**

### **Pandryshueshmëria e kapacitetit të alokuar ndër-zonal**

#### **Neni 69**

#### **Afati i pandryshueshmërisë të ditës në avancë**

OST-të do të zbatojnë një afat të vetëm të pandryshueshmërisë të ditës në avancë, i cili nuk duhet të jetë më i shkurtër se gjysëm ore përpara kohës së mbylljes së portës të tregut të ditës në avancë.

#### **Neni 70**

#### **Pandryshueshmëria e kapacitetit të ditës në avancë dhe kufizimet e alokimit**

1. Përpara afatit të pandryshueshmërisë të ditës në avancë, çdo llogaritës i kapacitetit të koordinuar mund të përshtasë kapacitetin ndër-zonal dhe kufizimet e alokimit të ofruara për NEMO-t përkatës.

2. Pas afatit të pandryshueshmërisë të ditës në avancë, i gjithë kapaciteti ndër-zonal dhe kufizimet e alokimit do të jenë të pandryshueshme për alokimin e kapacitetit të një ditë para, përveç nëse plotësohen kërkesat e nenit 46(2), në këtë rast kapaciteti ndër-zonal dhe kufizimet e alokimit do të bëhen të pandryshueshme sapo t'i dorëzohen NEMO-ve përkatës.

3. Pas afatit të pandryshueshmërisë të ditës në avancë, kapaciteti ndër-zonal i cili nuk është alokuar mund të përshtatet për alokimet e mëpasshme.

## **Neni 71**

### **Pandryshueshmëria e kapacitetit brenda së njëjtës ditë**

Kapaciteti ndër-zonal brenda së njëjtës ditë do të jetë i pandryshueshëm sapo të alokohet.

## **Neni 72**

### **Pandryshueshmëria në rast të forcës madhore ose në situata emergjente**

1. Në rast të forcës madhore ose një situatë emergjente, ku OST do të veprojë në mënyrë të shpejtë dhe ridispeçimi ose tregtimi me kah të kundërt nuk është i mundur, çdo OST do të ketë të drejtën të kufizojë kapacitetin e alokuar ndër-zonal. Në të gjitha rastet, kufizimi do të ndërmerret në mënyrë të koordinuar me të gjitha OST-të e interesuara drejtpërdrejtë.

2. Një OST që adreson forcën madhore ose një situatë emergjente duhet të publikojë një njoftim që shpjegon natyrën e forcës madhore ose situatën emergjente dhe kohëzgjatjen e mundshme të saj. Ky njoftim do t'u vihet në dispozicion pjesëmarrësve përkatës të tregut nëpërmjet NEMO-ve. Nëse kapaciteti u alokohet në mënyrë eksplicite pjesëmarrësve të tregut, OST-ja që ka adresuar forcën madhore ose situatën emergjente do t'u dërgojë njoftim drejtpërdrejtë palëve kontraktuese që kanë kapacitet ndër-zonal për afatin kohor përkatës të tregut.

3. Nëse kapaciteti i alokuar kufizohet për shkak të forcës madhore ose një situatë emergjente të adresuar nga një OST, OST do të rimbursojë ose kompensojë për periudhën e forcës madhore ose situatës emergjente, në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

(a) nëse alokimi është implicit, kundërpalët qendrore ose agjentët e transferimit nuk do të kenë dëm financiar ose përfitim financiar si rrjedhojë e çdo disbalance të krijuar nga një reduktim i tillë;

(b) në rast të forcës madhore, nëse kapaciteti alokohet nëpërmjet ankandit explicit, pjesëmarrësit e tregut do të kenë të drejtën e rimbursimit të çmimit të paguar për kapacitetin gjatë procesit të ankandit explicit;

(c) në një situatë emergjente, nëse kapaciteti alokohet nëpërmjet ankandit explicit, pjesëmarrësit e tregut do të kenë të drejtën e kompensimit të barabartë me diferencën e çmimeve të tregjeve përkatëse ndërmjet zonave të ofertimit respektive në afatin kohor përkatës; ose

(d) në një situatë emergjente, nëse kapaciteti alokohet nëpërmjet ankandit explicit, por çmimi i zonës së ofertimit nuk është llogaritur në të paktën njërën nga dy zonat përkatëse të ofertimit në afatin kohor përkatës, pjesëmarrësit e tregut do të kenë të drejtën e rimbursimit të çmimit të paguar për kapacitet gjatë procesit të ankandit explicit.

4. OST-ja që adreson forcën madhore ose situatën emergjente do të kufizojë pasojat dhe kohëzgjatjen e situatës së forcës madhore ose situatës emergjente.

5. Kur një Palë Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë e ka parashikuar këtë, me kërkesë të OST-së përkatëse, autoriteti kombëtar rregullator do të vlerësojë nëse një ngjarje kualifikohet si forcë madhore.

## **TITULLI III KOSTOT**

### **KAPITULLI 1**

#### **Metodologjia e shpërndarjes të të ardhurave nga kongjestioni për bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë**

##### **Neni 73**

#### **Metodologjia e shpërndarjes të të ardhurave nga kongjestioni**

1. OST-të do të zbatojnë metodologjinë për ndarjen e të ardhurave nga kongjestioni, përmendur në Nenin 9(6)(m).
2. Metodologjia nga paragrafi 1 do:
  - (a) të lehtësojë funksionimin dhe zhvillimin eficient afatgjatë të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike dhe funksionimin eficient të tregut të energjisë elektrike të Komunitetit të Energjisë;
  - (b) të jetë në përputhje me parimet e përgjithshme të menaxhimit të kongjestionit të parashikuara në Nenin 16 të Rregullores (BE) Nr. 2019/943;
  - (c) të lejojë një planifikim financiar të arsyeshëm;
  - (d) të jetë në përputhje me të gjitha periudhat kohore;
  - (e) të lidhë marrëveshje për ndarjen e të ardhurave nga kongjestioni që rrjedhin nga asetet e transmetimit në pronësi të palëve të ndryshme nga OST.
3. OST-të do të shpërndajnë të ardhurat nga kongjestioni në përputhje me metodologjinë në paragrafin 1 sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme dhe jo më vonë se një javë pasi të ardhurat nga kongjestioni të jenë transferuar në përputhje me Nenin 68(8).

### **KAPITULLI 2**

#### **Metodologjia e ndarjes së kostos së ridispeçimit dhe tregtimit me kah të kundërt për bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë apo brenda së njëjtës ditë**

##### **Neni 74**

#### **Metodologjia e ndarjes së kostos së ridispeçimit dhe tregtimit me kah të kundërt**

1. Jo më vonë se 16 muaj pas marrjes së vendimit për rajonet e llogaritjes së kapacitetit, të gjithë OST-të në secilin rajon të llogaritjes së kapacitetit do të hartojnë një propozim për një metodologji të përbashkët për ndarjen e kostos së ridispeçimit dhe tregtimit me kah të kundërt.
2. Metodologjia e ndarjes së kostos së ridispeçimit dhe tregtimit me kah të kundërt do të përfshijë zgjidhjen e ndarjes së kostos për operacionet me rëndësi ndërkufitare.
3. Kostot e ridispeçimit dhe tregtimit me kah të kundërt të cilat ndahen mes OST-ve përkatëse do të përcaktohen në mënyrë transparente dhe të auditueshme.
4. Metodologjia e ndarjes së kostos së ridispeçimit dhe tregtimit me kah të kundërt duhet të paktën:

(a) të përcaktojë se cilat kosto të shkaktuara nga përdorimi i veprimeve përmirësuese, kosto të cilat janë marrë në konsideratë në llogaritjen e kapacitetit dhe ku është krijuar një kuadër i përbashkët për përdorimin e veprimeve të tilla, janë të pranueshme për t'u ndarë ndërmjet të gjithë OST-ve të një rajoni të llogaritjes së kapacitetit në përputhje me metodologjinë e llogaritjes së kapacitetit të përcaktuar në Nenet 20 dhe 21;

(b) të përcaktojë se cilat kosto të shkaktuara nga përdorimi i ridispeçimit ose tregtimit me kah të kundërt për të garantuar pandryshueshmërinë e kapacitetit ndër-zonal, janë të pranueshme për t'u ndarë ndërmjet të gjithë OST-ve të një rajoni të llogaritjes së kapacitetit në përputhje me metodologjinë e llogaritjes së kapacitetit të përcaktuar në Nenet 20 dhe 21;

(c) të vendosë rregulla për ndarjen e kostove në mbarë rajonin siç përcaktohet në përputhje me pikat (a) dhe (b).

5. Metodologjia e hartuar në përputhje me paragrafin 1 do të përfshijë:

(a) një mekanizëm për të verifikuar nevojën aktuale për ridispeçim ose tregtim me kah të kundërt ndërmjet OST-ve të përfshira;

(b) një mekanizëm ex-post për të monitoruar përdorimin e veprimeve përmirësuese me kosto;

(c) një mekanizëm për të vlerësuar ndikimin e veprimeve përmirësuese, bazuar në sigurinë e operimit dhe kriteret ekonomike;

(d) një proces që lejon përparimin e veprimeve përmirësuese;

(e) një proces që lejon monitorimin e çdo rajoni të llogaritjes së kapacitetit nga autoritetet rregullatore kompetente.

6. Metodologjia e hartuar në përputhje me paragrafin 1 do:

(a) të ofrojë stimuj për të menaxhuar kongestionin, duke përfshirë veprimet përmirësuese dhe stimuj për të investuar në mënyrë efektive;

(b) të jetë në përputhje me përgjegjësitë dhe detyrimet e OST-ve të përfshira;

(c) të sigurojë një shpërndarje të drejtë të kostove dhe përfitimeve ndërmjet OST-ve të përfshira;

(d) të jetë në përputhje me mekanizmat e tjerë përkatës, duke përfshirë të paktën:

(i) metodologjinë për ndarjen e të ardhurave nga kongjestioni, përcaktuar në Nenin 73;

(ii) mekanizmin e kompensimit ndërmjet OST-ve, përcaktuar në Nenin 49 të Rregullores (BE) Nr. 2019/943 siç është përfshirë dhe përshtatur me Vendimin e Këshillit Ministeror 2022/03/MC-EnC dhe Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 838/2010 siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2013/01-PHLG-EnC;

(e) të lehtësojë funksionimin dhe zhvillimin efiçent afatgjatë të sistemit pan-evropian të interkoneksioneve dhe funksionimin efiçent të tregut pan-evropian të energjisë elektrike;

(f) të lehtësojë respektimin e parimeve të përgjithshme të menaxhimit të kongjestionit siç përcaktohet në Nenin 16 dhe 19 të Rregullores (BE) Nr. 2019/943 siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Këshillit Ministeror 2022/03/MC-EnC;



(g) të lejojë planifikim të arsyeshëm financiar;

(h) të jetë në përputhshmëri përgjatë afateve kohore të tregut të ditës në avancë ose brenda së njëjtës ditë; dhe

(i) të jetë në përputhje me parimet e transparencës dhe mosdiskriminimit.

7. OST-të e çdo rajoni të llogaritjes së kapacitetit do të harmonizojnë më tej, sa më shumë që të jetë e mundur ndërmjet rajoneve, metodologjitë e ndarjes së kostos së ridispeçimit dhe tregtimit me kah të kundërt të aplikuara brenda rajonit të tyre përkatës të llogaritjes së kapacitetit.

### **KAPITULLI 3**

#### **Mbulimi i kostove të alokimit të kapacitetit dhe menaxhimit të kongestionit**

##### **Neni 75**

##### **Dispozita të përgjithshme mbi mbulimin e kostove**

1. Kostot në lidhje me detyrimet e vendosura ndaj OST-ve në përputhje me Nenin 8, duke përfshirë kostot e specifikuar në Nenin 74 dhe Nenet 76 deri në 79, do të vlerësohen nga autoritetet rregullatore kompetente. Kostot e vlerësuara si të arsyeshme, efikente dhe proporcionale do të mbulohen në kohën e duhur nëpërmjet tarifave të rrjetit ose mekanizmave të tjerë të përshtatshëm siç përcaktohet nga autoritetet rregullatore kompetente.

2. Pjesa e secilës Pale Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë në kostot e përbashkëta të përmendura në Nenin 80(2)(a), kostot rajonale të përmendura në Nenin 80(2)(b) dhe kostot kombëtare të përmendura në Nenin 80(2)(c), të vlerësuara si të arsyeshme, efikente dhe proporcionale, do të rikupërohen nëpërmjet tarifave të NEMO-ve, tarifave të rrjetit ose mekanizmave të tjerë të përshtatshëm siç përcaktohet nga autoritetet rregullatore kompetente.

3. Nëse kërkohet nga autoritetet rregullatore, OST-të, NEMO-t dhe përfaqësuesit përkatës në përputhje me Nenin 78, brenda tre muajve nga kërkesa, do të japin informacionin e nevojshëm për të mundësuar vlerësimin e kostove të bëra.

##### **Neni 76**

##### **Kostot e themelimit, ndryshimit dhe funksionimit të bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë**

1. NEMO-t nga Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë do të kontribuojnë në përballimin e kostove të mëposhtme:

(a) kostot e përbashkëta, rajonale dhe kombëtare, të themelimit, përditësimit ose zhvillimit të mëtejshëm të algoritmit të çmimit të tregut të bashkuar dhe bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë;

(b) kostot e përbashkëta, rajonale dhe kombëtare, të themelimit, përditësimit ose zhvillimit të mëtejshëm të algoritmit të përputhjes së tregtimit të vazhdueshëm dhe bashkimit të tregut të vetëm brenda së njëjtës ditë;

(c) kostot e përbashkëta, rajonale dhe kombëtare, të funksionimit të bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë.

2. Në varësi të marrëveshjes me NEMO-t përkatës, OST-të mund të japin një kontribut në kostot e parashikuara në paragrafin 1, që i nënshtrohet miratimit nga autoritetet rregullatore përkatëse. Në raste të tilla, brenda dy muajve nga marrja e një parashikimi nga NEMO-t përkatës, çdo OST do të ketë të drejtë t'i japë për miratim autoritetit rregullator përkatës një propozim për kontribut në kosto.

3. NEMO-t përkatës do të kenë të drejtë të mbulojnë kostot në përputhje me paragrafin 1, të cilat nuk janë përballuar nga OST-të në përputhje me paragrafin 2, me anë të tarifave ose mekanizmave të tjerë të përshtatshëm, vetëm nëse kostot janë të arsyeshme dhe proporcionale, nëpërmjet marrëveshjeve kombëtare me autoritetin rregullator kompetent.

## **Neni 77**

### **Kostot e klerimit dhe shlyerjes**

1. Të gjitha kostot e bëra nga kundërpalët qendrore dhe agjentët e transferimit do të rikuperohen me anë të tarifave ose mekanizmave të tjerë të përshtatshëm nëse ato janë të arsyeshme dhe proporcionale.

2. Kundërpalët qendrore dhe agjentët e transferimit do të kërkojnë marrëveshje efiçente të klerimit dhe shlyerjes duke shmangur kostot e panevojshme dhe reflektuar rrezikun e shkaktuar. Marrëveshjet ndërkufitare të klerimit dhe shlyerjes do t'i nënshtrohen miratimit nga autoritetet rregullatore kombëtare përkatëse.

## **Neni 78**

### **Kostot e themelimit dhe funksionimit të procesit të koordinuar të llogaritjes të kapacitetit**

1. Çdo OST do të përballojë individualisht kostot e sigurimit të inpueteve në procesin e llogaritjes së kapacitetit.

2. Të gjitha OST-të do të përballojnë së bashku kostot e bashkimit të modeleve individuale të rrjetit. Të gjitha OST-të në çdo rajon të llogaritjes së kapacitetit do të përballojnë kostot e themelimit dhe funksionimit të llogaritësve të kapacitetit të koordinuar.

3. Çdo kosto e shkaktuar nga pjesëmarrësit e tregut në përmbushjen e kërkesave të kësaj Rregulloreje do të përballohet nga ata pjesëmarrës të tregut.

## **Neni 79**

### **Kostot e sigurimit të pandryshueshmërisë**

Kostot e sigurimit të pandryshueshmërisë në përputhje me Nenet 70(2) dhe 71 do të përballohen nga OST-të përkatëse, për aq sa është e mundur në përputhje me Nenin 19(2)(a) të Rregullores (KE) Nr. 2019/943 siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Këshillit Ministeror 2022/03/MC-EnC. Këto kosto do të përfshijnë kostot nga mekanizmat e kompensimit që lidhen me sigurimin e pandryshueshmërisë së kapaciteteve ndër-zonale, si dhe kostot e ridispeçimit, tregtimit me kah të kundërt dhe disbalancave të lidhura me kompensimin e pjesëmarrësve të tregut.

## **Neni 80**

### **Ndarja e kostos ndërmjet NEMO-ve dhe OST-ve në Shtete Anëtare dhe Palë të ndryshme Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë**

1. Të gjithë NEMO-t dhe OST-të përkatëse do t'u ofrojnë autoriteteve rregullatore një raport vjetor, në të cilin shpjegohen në detaje kostot e themelimit, ndryshimit dhe funksionimit të bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë. Ky raport do të publikohet nga Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë duke marrë parasysh informacionin e ndjeshëm komercial. Kostot e lidhura drejtpërdrejtë me bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë duhet të identifikohen veçmas, në mënyrë të qartë si dhe të jenë të auditueshme. Raporti do të sigurojë gjithashtu detaje të plota të kontributeve të bëra në kostot e NEMO nga OST-të në përputhje me Nenin 76(2).

2. Kostot e përmendura në paragrafin 1 duhet të ndahen në:

(a) kosto të përbashkëta që rezultojnë nga aktivitetet e koordinuara të të gjithë NEMO-ve ose OST-ve nga Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe Shtete Anëtare (për interkoneksionet e tyre me Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë), që marrin pjesë në bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë;

(b) kosto rajonale që rezultojnë nga aktivitetet e NEMO-ve ose OST-ve që bashkëpunojnë në një rajon të caktuar;

(c) kosto kombëtare që rezultojnë nga aktivitetet e NEMO-ve ose OST-ve në atë Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë.

3. Kostot e përbashkëta të përmendura në paragrafin 2(a) do të ndahen ndërmjet OST-ve dhe NEMO-ve në Shtetet Anëtare dhe Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë në përputhje me Nenin 80(3) të Rregullores së Komisionit (BE) 2015-1222.

4. NEMO-t dhe OST-të që bashkëpunojnë në një rajon të caktuar do të bien dakord së bashku për një propozim për ndarjen e kostove rajonale në përputhje me paragrafin 2(b). Propozimi më pas do të miratohet individualisht nga autoritetet kombëtare kompetente të secilës prej Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe Shteteve Anëtare në rajon. NEMO-t dhe OST-të që bashkëpunojnë në një rajon të caktuar mund të përdorin në mënyrë alternative marrëveshjet e ndarjes së kostove.

5. Parimet e ndarjes së kostove do të zbatohen për kostot e shkaktuara nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje. Kjo nuk paragjykon zgjidhjet ekzistuese të përdorura për zhvillimin e bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, dhe kostot e bëra para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje do të ndahen ndërmjet NEMO-ve dhe OST-ve bazuar në marrëveshjet ekzistuese që rregullojnë këto zgjidhje.

## **TITULLI IV**

### **DELEGIMI I DETYRAVE DHE MONITORIMI**

## **Neni 81**

### **Delegimi i detyrave**

1. Një OST ose NEMO mund t'i delegojë të gjitha ose një pjesë të detyrave që i janë caktuar sipas kësaj Rregulloreje, tek një ose më shumë palë të treta, në rast se pala e tretë mund të kryejë funksionin përkatës në mënyrë efektive të paktën sa subjekti delegates. Subjekti delegates mbetet përgjegjës për

sigurimin dhe respektimin e detyrimeve sipas kësaj Rregulloreje, përfshirë sigurimin e aksesit në informacionin e nevojshëm për monitorim nga autoriteti rregullator.

2. Përpara delegimit, pala e tretë e interesuar duhet t'i ketë treguar qartë palës deleguese aftësinë për të përmbushur secilin prej detyrimeve të kësaj Rregulloreje.

3. Në rast se e gjitha ose një pjesë e ndonjë detyre të specifikuar në këtë Rregullore i delegohet një pale të tretë, pala deleguese do të sigurojë përpara delegimit lidhjen e marrëveshjeve të përshtatshme të konfidencialitetit në përputhje me detyrimet e konfidencialitetit të palës deleguese.

## **Neni 82**

### **Monitorimi i zbatimit të bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë**

1. Subjekti ose subjektet që kryejnë funksionet e OBT do të monitorohen nga autoritetet rregullatore ose autoritetet përkatëse të territorit ku ndodhen. Autoritetet e tjera rregullatore ose autoritetet përkatëse, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, duke vepruar në përputhje me Nenin 2 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC, do të kontribuojnë në monitorim, ku është e mundur. Autoritetet rregullatore ose autoritetet përkatëse kryesisht përgjegjëse për monitorimin e një NEMO dhe funksioneve të OBT, do të bashkëpunojnë plotësisht dhe do të ofrojnë akses në informacion për autoritetet e tjera rregullatore, Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe Agjencinë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë dhe, për të siguruar monitorimin e duhur të bashkimit të tregut të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë në përputhje me Nenin 61 të Direktivës 2019/944 të përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Këshillit Ministeror 2021/13/MC-EnC.

2. Monitorimi i zbatimit të integritetit të Palës Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë në bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë nga Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, duke vepruar në përputhje me Nenin 2 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC, do të kryhet në koordinim me Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

3. <...>

4. <...>

5. Të gjitha OST-të do t'i dorëzojnë Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë informacionin e kërkuar për kryerjen e detyrave në përputhje me paragrafin 2.

6. NEMO-t, pjesëmarrësit e tregut dhe organizatat e tjera përkatëse në lidhje me bashkimin e tregut të vetëm të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, me kërkesë të përbashkët të Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë ose, në rast se Shtetet Anëtare preken, Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë dhe ENTSO-E, duke vepruar në përputhje me Nenin 2 dhe 3 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC, do t'i dorëzojnë ENTSO-E informacionin e kërkuar për monitorim në përputhje me paragrafin 2, përveç informacionit të marrë tashmë nga autoritetet rregullatore, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë ose ENTSO-E në kontekstin e detyrave të tyre respektive të monitorimit dhe zbatimit.

**TITULLI V**  
**DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

**Neni 83**

**Dispozita kalimtare për Irlandën dhe Irlandën e Veriut**

<...>

**Neni 84**

**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi me miratimin e saj nga Enti Rregullator i Energjisë.

## **Shtojca I**

### **Rajonet e llogaritjes së kapacitetit**

#### **Neni 1**

##### **Objekti dhe fushëveprimi**

1. Rajonet e llogaritjes së kapacitetit (RLIK) mbulojnë të gjithë kufijtë ekzistues të zonës së ofertimit ndërmjet Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe Shteteve Anëtare, siç përcaktohen në këtë Shtojcë.

2. Rregullimet e konfigurimit të RLIK-ve të listuara në këtë Shtojcë do t'i nënshtrohen një propozimi të të gjithë operatorëve të sistemit të transmetimit në përputhje me Nenin 15 paragrafët 2 dhe 3 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 në konsultim me OST-të nga Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë.

#### **Neni 2**

##### **Rajonet e llogaritjes së kapacitetit**

Më poshtë përcaktohen si RLIK të Komunitetit të Energjisë:

- Rajoni i llogaritjes së kapacitetit në hije i Evropës Juglindore (SEE RLIK në Hijë)
- Rajoni i llogaritjes së kapacitetit Itali - Mali i Zi (ITME RLIK)
- Rajoni i llogaritjes së kapacitetit i Evropës Lindore (EE RLIK)

#### **Neni 3**

##### **Rajoni i llogaritjes së kapacitetit: SEE RLIK në Hijë**

RLIK në Hijë i Evropës Juglindore do të përfshijë kufijtë e zonës së ofertimit ndërmjet Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë:

- Bosnje dhe Hercegovinë – Serbi (BA-RS), Nezhavisni operator sistema u Bosni i Hercegovini (NOS BiH) dhe Elektromreza Srbije AD (EMS)
- Mali i Zi – Bosnje dhe Hercegovinë (ME-BA), Crnogorski elektroprenosni sistem AD (CGES) dhe Nezhavisni operator sistema u Bosni i Hercegovini (NOS BiH)
- Mali i Zi – Shqipëri (ME-AL), Crnogorski elektroprenosni sistem AD (CGES) dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST)
- Shqipëri – Maqedonia e Veriut (AL-MK), Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST) dhe Makedonski Elektroprenosen Sistem Operator AD (MEPSO)
- Serbi – Maqedonia e Veriut (RS-MK), Elektromreza Srbije AD (EMS) dhe Makedonski Elektroprenosen Sistem Operator AD (MEPSO)
- Mali i Zi – Serbi (ME-RS), Crnogorski elektroprenosni sistem AD (CGES) dhe Elektromreza Srbije AD (EMS)

- Mali i Zi – Kosovë (ME-KS), Crnogorski elektroprenosni sistem AD (CGES) dhe Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu Sh.A. (KOSTT)
- Shqipëri – Kosovë (AL-KS), Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST) dhe Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu Sh.A. (KOSTT)
- Maqedonia e Veriut – Kosovë (MK-KS), Makedonski Elektroprenosen Sistem Operator AD (MEPSO) dhe Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu Sh.A. (KOSTT)
- Serbi – Kosovë (RS-KS), Elektromreza Srbije AD (EMS) dhe Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu Sh.A. (KOSTT).

Të gjitha OST-të e SEE RLIK në Hije, brenda 6 muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, do të lidhin një marrëveshje me OST-të e EU SEE RLIK si bazë për bashkëpunimin e OST-ve të Shteteve Anëtare dhe Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë në SEE RLIK në Hije. Kjo marrëveshje do të zbatohet për OST-të e mëposhtme dhe për kufijtë e mëposhtëm:

- Kroaci – Bosnje dhe Hercegovinë (HR - BA), Croatian Transmission System Operator Ltd. (HOPS) dhe Nezavisni operator sistema u Bosni i Hercegovini (NOS BiH)
- Kroaci – Serbi (HR - RS), Croatian Transmission System Operator Ltd. (HOPS) dhe Elektromreza Srbije AD (EMS)
- Hungari – Serbi (HU - RS), Hungarian Independent Transmission Operator Company Ltd (MAVIR) dhe Elektromreza Srbije AD (EMS)
- Rumani – Serbi (RO - RS), Compania Natională de Transport al Energiei Electrice “Transelectrica” S.A. dhe Elektromreza Srbije AD (EMS)
- Bullgari – Serbi (BG - RS), Elektroenergien Sistemen Operator EAD (ESO) dhe Elektromreza Srbije AD (EMS)
- Bullgari – Maqedonia e Veriut (BG - MK), Elektroenergien Sistemen Operator EAD (ESO) dhe Makedonski Elektroprenosen Sistem Operator AD (MEPSO)
- Greqi – Maqedonia e Veriut (BG - MK), Independent Power Transmission Operator S.A. (IPTO) dhe Makedonski Elektroprenosen Sistem Operator AD (MEPSO)
- Greqi – Shqipëri (GR - AL), Independent Power Transmission Operator S.A. (IPTO) dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST)

#### **Neni 4**

##### **Rajoni i Ilogaritjes së kapacitetit: ITME RLIK**

ITME RLIK do të përfshijë kufirin e zonës së ofertimit ndërmjet Italisë dhe Malit të Zi (IT-ME), TERNA Rete Elettrica Nazionale S.p.A (TERNA) dhe Crnogorski elektroprenosni sistem AD (CGES)

#### **Neni 5**

##### **Rajoni i Ilogaritjes së kapacitetit: EE RLIK**

RLIK i Evropës Lindore do të përfshijë kufirin e zonës së ofertimit ndërmjet Ukrainës dhe Moldavisë (UA - MD), Ukrenergo NPC SE (Ukrenergo) dhe I.S. Moldelectrica (MED).

Në lidhje me kufijtë e zonës së ofertimit ndërmjet Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe Shteteve Anëtare, të gjitha OST-të e EE RLIK brenda 6 muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, do të lidhin një marrëveshje me OST-të e EU SEE RLIK, duke vendosur bazën për bashkëpunimin e OST-ve të BE dhe jo të BE në EE RLIK. Kjo duhet të zbatohet për OST-të e mëposhtme dhe për kufijtë e mëposhtëm:

- Ukraine - Poloni (UA - PL), Ukrenergo NPC SE (Ukrenergo) dhe PSE S.A. (PSE)
- Ukraine - Sllovakia (UA - SL), Ukrenergo NPC SE (Ukrenergo) dhe Slovenská elektrizaná prenosová sústava, a.s. (SEPS)
- Ukraine - Hungari (UA - HU), Ukrenergo NPC SE (Ukrenergo) dhe Hungarian Independent Transmission Operator Company Ltd (MAVIR)
- Ukraine - Rumani (UA - RO), Ukrenergo NPC SE (Ukrenergo) dhe Compania Natională de Transport al Energiei Electrice "Transelectrica" S.A (TEL)
- Moldavi - Rumani (MD - RO), I.S. Moldelectrica (MED) dhe Compania Natională de Transport al Energiei Electrice "Transelectrica" S.A (TEL).